

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5407
E enjte, 22 shkurt 2018
çmimi 0.40 €

Pacolli pret që Spanja ta njohë së shpejti pavarësinë e Kosovës



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

**META: TË PAPRANUESHME
IDETË PËR NDARJE APO PËR
SHKËMBIM TERRITORESH F. 2**

**PËRMBYLLET GARA ME
TABELA NË 250 SHKOLLA TË
KOSOVËS F. 6**

**MINISTRIA E MJEDISIT,
GJASHTË PROJEKTE PËR
MITROVICËN F. 10**

EKONOMI

**KOSOVA PREZANTOHET
ME 30 PROJEKTE NË
SAMITIN E LONDRËS F. 98**

**VLERA E LIRIMEVE NGA
TATIMI DOGANOR PËR LËNDËN
E PARË ËSHTË MBI 357 MIJË
EURO F. 8**

KULTURË

**LUFTA E SHOTË
GALICËS DHE
SHTETI SHQIPTAR
F. 15**



Afërdita DERVISHI

SPORT

**KORENICA: PLAGËN E KUPËS
E SHËROJMË NË KAMPIONAT
F. 18**

**GREENBERGU: NDAJ
POLONISË MUND TË BËJMË
GJERA TË MIRA F. 18**



FLET PËR "EPOKËN E RE", LUTFI HAZIRI ■ FAQE 4-5

Me ratifikimin e demarkacionit, Kosova zë hapin e fundit për vizat

Nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lutfi Haziri, ka bërë me dije se deputetët e kësaj partie janë unikë në votën për Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes së kufirit ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi. Në këtë

intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se nëse demarkacioni nuk ratifikohet, Kosova e humbet çastin e fundit për ta marrë liberalizimin e vizave. Haziri ka folur edhe për dialogun me Serbinë, duke bërë me dije se ky proces do të

mbyllet me një rol aktiv të LDK-së. Ai ka thënë se nuk mund të ketë kurrfarë rezultati të pritur dhe përfundim të dialogut pa përfshirjen e të gjithë aktorëve kryesorë në Kosovë, do të thotë edhe pa përfshirjen e opozitës

Sot beteja për ratifikimin e demarkacionit



Kryesia e Kuvendit të Kosovës ka miratuar kërkesën e kryeministrit Ramush Haradinaj, që seanca e jashtëzakonshme për ratifikimin e demarkacionit me Malin e Zi të mbahet sot (e enjte) në orën

11:00. Partnerët e koalicionit qeverisës, PDK-ja, AAK-ja, Nisma Socialdemokrate dhe AKR-ja, kanë konfirmuar se deputetët e tyre do ta votojnë këtë marrëveshje. Edhe grupi parlamentar i

LDK-së ka dalë me qëndrim pozitiv, duke konfirmuar votën për këtë marrëveshje. Ndërkaq Lëvizja Vetëvendosje ka paralajmëruar se deputetët e saj do të votojnë kundër kësaj marrëveshje ■ FAQE 3



Veseli, afat deputetëve: Shqyrtojini të gjitha ligjet deri më 31 mars ■ FAQE 7

RENOVA
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Çarëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GRUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel & Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjobiznesi.com
info@kolegjobiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Meta: Të papranueshme idetë për ndarje apo për shkëmbim territoresh

TIRANË, 21 SHKURT - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, ka pritur të mërkurën në takim delegacionin e Këshillit Evropian për Marrëdhëniet me Jashtë, i kryesuar nga Carl Bildt, ish-kryeministër dhe ministër i Punëve të Jashtme të Suedisë. Gjatë këtij takimi Meta ka theksuar rëndësinë që ka zgjerimi i BE-së edhe me gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në këtë kontekst vuri në dukje se

shpreson që Shqipëria t'i hapë sa më parë negociatat e anëtarësimit në BE dhe që Kosova ta përftojë liberalizimin e vizave sapo të mbyllet marrëveshja e demarkacionit me Malin e Zi.

Më tej, Meta i konsideroi të papranueshme dhe të pamundura idetë destruktive për ndarje apo shkëmbime territoresh, duke i konsideruar ato tentativa të dëshpëruara

për mbivendosjen e agjendave populiste mbi agjendat jetike të integritetit dhe stabilitetit. Për Metën programi i vetëm i punës në tryezat e drejtuesve politikë duhet të jenë zgjidhja e problemeve të shqetësimeve reale të qytetarëve, për ta vendosur sundimin e ligjit dhe demokracisë në secilin vend. "Prioritet në secilin vend, sundimin e ligjit dhe demokracisë", ka thënë Meta.



Kosova, përparim të lehtë në luftën kundër korrupsionit

Në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit për vitin 2017, Kosova sivjet radhitet e 85-ta, me 39 pikë, që do të thotë se ka bërë përparim të lehtë në luftën kundër korrupsionit krahasuar me vitin paraprak kur ka qenë në vendin e 95-të me 36 pikë

PRISHTINË, 21 SHKURT - Organizata ndërkombëtare Transparency International publikoi të mërkurën Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit për vitin 2017, i cili tregon prani të madhe të kësaj dukurie në më shumë se dy të tretat e vendeve ku janë bërë matjet. Transparency International tha se vendet me mbrojtjen më të vogël për shtypin dhe organizatat joqeveritare kanë prirje të kenë normat më të këqija të korrupsionit. "Derisa frenimi i valës së korrupsionit kërkohet kohë, në gjashtë vjetët e fundit shumë vende kanë bërë pak ose aspak përparim", vlerësoi Transparency

International.

Indeksi, i cili radhit 180 vende dhe territore në bazë të nivelit të perceptuar të korrupsionit në sektorin publik, përdor një shkallë prej zero pikësh deri në 100, ku zero tregon për një vend shumë të korruptuar, ndërsa 100 një vend shumë të pastër.

Në këtë indeks, Kosova sivjet radhitet e 85-ta, me 39 pikë, që do të thotë se ka bërë përparim të lehtë në luftën kundër korrupsionit, krahasuar me vitin paraprak kur ka qenë në vendin e 95-të me 36 pikë.

Drejtori i Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit, Shaip



Havolli, hedh topin tek institucionet e zbatimit të ligjit, në veçanti prokuroria, gjykatat dhe policia, duke thënë se ato duhet të

jenë më aktive në këtë luftë. "Agjencia Kundër Korrupsionit, gjatë gjithë vitit 2017, konform mandatit të saj, ka ndërmarrë

veprime konkrete sa i përket luftimit dhe parandalimit të korrupsionit. Shumë raste i ka dërguar në prokuroritë përkatëse, me kallëzime penale. Po ashtu, në fushën e konfliktit të interesit ka bërë shumë vendime, në çështjet e prokurimit, në çështjet e deklarimit të pasurisë", thotë Havolli, por shton se asnjë aktakuzë e ngritur nga prokuroria nuk ka përfunduar me aktgjykim të prerë, ka njoftuar "rfe".

Lufta kundër korrupsionit dhe rezultatet konkrete në këtë drejtim janë pjesë e kushteve të Bashkimit Evropian për liberalizimin e vizave për Kosovën.

Në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit, që publikoi organizata Transparency International, Shqipëria ka shënuar përqësime, duke zbritur në pozitën numër 91, nga 83 sa ka qenë në vitin paraprak.

Pacolli pret që Spanja ta njohë së shpejti pavarësinë e Kosovës

Prishtinë, 21 shkurt - Intervista e ministrit të Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, për agjencinë shtetërore spanjolle të lajmeve "EFE", ka bërë jehonë të madhe në mediet latine-amerikane dhe ato evropiane.

Një nga gazetaret më të lexuara në Spanjë, "La Vanguardia", në një artikull të gjatë kushtuar intervistës së ministrit Pacolli, i titulluar: "Kosova përsërit se rasti i saj nuk ka të bëjë me atë të



Katalunjës", ndër të tjera shkruan edhe se "Pacolli shpreh besimin e

tij në një njohje të shpejtë të pavarësisë së vendit të tij nga

Spanja", dhe se rasti i Kosovës nuk është i "krahasueshëm" me atë të Katalunjës.

Intervistës së ministrit Pacolli i është dhënë rëndësi e madhe edhe nga vetë mediet evropiane. "Deutsche Welle", në një artikull të publikuar në versionin e saj në spanjisht, me titull: "Kosova beson të arrijë marrëveshje me Serbinë për ta siguruar hyrjen në BE", citon ministrin Pacolli të ketë thënë se "do ta kemi një marrëveshje me Serbinë, e cila do të duhet të prano-

jë se Kosova ekziston dhe është një shtet i pavarur, dhe Kosova të pranojë se Serbia është fqinji ynë, i rëndësishëm për paqe dhe prosperitet në Ballkan".

Gazeta panameze "La Estrella de Panama", në artikullin e saj të titulluar "Kosova kërkon ta tejkalojë bllokimin për të hyrë në BE", shkruan se ministri Pacolli shpreson që Spanja, një nga pesë vendet e BE-së që nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës, "do ta njohë atë së shpejti - nëse jo sot, nesër".

ShBA-ja e zhgënjyer nga deklaratat e Edi Ramës

TIRANË, 21 SHKURT - Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë ka reaguar të mërkurën për deklaratat e kryeministrit Edi Rama në Kuvendin e Kosovës, për një president të përbashkët në mes të Shqipërisë dhe Kosovës. Në qëndrimin e ShBA-së theksohet se gjuha e përdorur, që aludon

për bashkim mes dy shteteve, është e padobishme dhe dëmton marrëdhëniet e Shqipërisë me vendet e tjera në rajon. "Ambasada e ShBA-së mbeti e zhgënjyer nga deklaratat e kryeministrit Rama mbi Shqipërinë dhe Kosovën me rastin e 10-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Gjuha e shkujdesur,

që aludon për bashkim, është e padobishme dhe dëmton marrëdhëniet e Shqipërisë me vendet fqinje. Ne u bëjmë thirrje udhëheqësve të jenë fqinjë të mirë dhe ta lënë mënjanë gjuhën ndarëse të së shkuarës", thuhet në reagimin e ambasadës.

Qëndrimi i Ambasadës së

ShBA-së është i sinjali i dytë i fortë që Edi Rama ka marrë gjatë ditëve të fundit për gjuhën e përdorur në Prishtinë. Të hënën ishte zëdhënësja e Komisionit Evropian që reagoi për deklaratat e kryeministrit shqiptar. Sipas BE-së, retorika e përdorur nga Edi Rama nuk i shërben fqinjësisë së mirë në

Ballkan.

Në fjalimin e mbajtur në Kuvendin e Kosovës, të dielën, Edi Rama tha se "Kosova dhe Shqipëria do të kenë një politikë të jashtme ejo veç ambasada dhe përfaqësi diplomatike të njëjta por, pse jo, një president, simbol të unitetit kombëtar dhe një politikë kombëtare të sigurisë".

Seanca e jashtëzakonshme për demarkacionin me Malin e Zi mbahet sot

Sot beteja për ratifikimin e demarkacionit

Kryesia e Kuvendit të Kosovës ka miratuar kërkesën e kryeministrit Ramush Haradinaj, që seanca e jashtëzakonshme për ratifikimin e demarkacionit me Malin e Zi të mbahet sot (e enjte) në orën 11:00. Partnerët e koalicionit qeverisës, PDK-ja, AAK-ja, Nisma Socialdemokrate dhe AKR-ja, kanë konfirmuar se deputetët e tyre do ta votojnë këtë marrëveshje. Edhe grupi parlamentar i LDK-së ka dalë me qëndrim pozitiv, duke konfirmuar votën për këtë marrëveshje. Ndërkaq Lëvizja Vetëvendosje ka paralajmëruar se deputetët e saj do të votojnë kundër kësaj marrëveshje

bërë me dije se kjo parti mbetet konsistente në qëndrimin e saj rreth marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi. "Partia Demokratike e Kosovës ka qenë dhe mbetet konsistente në qëndrimin e saj rreth marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi. Edhe një herë sot me grupin parlamentar theksuam nevojën që kjo marrëveshje të ratifikohet sa më parë, me një konsensus të gjerë politik, dhe Kosova të ecë në agjendën e integriteteve evropiane", ka thënë Veseli.

Edhe deputetët të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) të mërkurën kanë bërë me dije se vota e tyre do të jetë për demarkacionin.

Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, pas takimeve me ambasadorin amerikan Greg Delawie dhe shefen e Zyrës së BE-së, Natalia Apostolova, ka deklaruar edhe një herë qëndrimin e LDK-së sa i përket procesit të ratifikimit të kësaj marrëveshjeje dhe ka konfirmuar votën unanime për grupin parlamentar. Gjithashtu, Hoti e ka cilësuar të çmueshme mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të shteteve të BE-së gjatë këtij procesi dhe i ka falënderuar ata për mbështetjen

që po ia japin vendit. Delawie dhe Apostolova gjatë ditës së mërkurë kanë takuar edhe deputetët e PDK-së. Ndërsa AAK-ja dhe Nisma qëndrimin e tyre rreth kësaj marrëveshjeje e kanë ndryshuar pas nënshkrimit të deklarates së përbashkët për këtë çështje në mes të presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi dhe homologut të tij nga Mali i Zi, Filip Vujanović.

Lëvizja Vetëvendosje kundër demarkacionit

Një ditë para se demarkacioni të ratifikohet në Kuvendin e Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje ka rikonfirmuar qëndrimin e vet kundër kësaj marrëveshjeje. Lideri i këtij subjekti politik, Albin Kurti, në një konferencë për medie të mërkurën, ka thënë se marrëveshja ndërmjet presidentit malazez Filip Vujanović dhe presidentit Hashim Thaçi është një manipulim që po bëhet për t'i shpëtuar disa persona të Qeverisë. Ai ka theksuar se për liberalizimin e vizave nuk është kusht vetëm ratifikimi i marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi. Sipas tij, edhe luftimi i korrupsionit dhe krimin të

organizuar është kusht për liberalizim të vizave. "Demarkacioni me Malin e Zi, që është kufi i ri sipas komisionit të dikurshëm Meha dhe nënshkrimit të Thaçit në Vjenë më 26 shkurt 2015, në Kosovë po interpretohet si çmim për liberalizim. Mirëpo ka shumë procedura të brendshme për liberalizim. Prandaj shtrohet pyetja, pse gjithë kjo nguti me demarkacionin nga Thaçi e Haradinaj?! Ata qartazi nuk e kanë për liberalizim sepse nuk e kanë për qytetarët. Nëse do ta kishin për qytetarët nuk do të pasuroheshin e nuk do të falnin tokë. E kanë për karriget e tyre e jo për qytetarët", ka thënë Kurti.

Kurse shefi i grupit parlamentar i IV-së, Glauk Konjufca, ka treguar se kjo lëvizje do të mundohet ta pamundësojë arrijten e kuorumit. "Kur u krijua koalicioni AAK - PDK i patëm thënë Ramushit që, nëse bën koalicion me Kadri Veselin, nuk e ndryshon Kosovën, por bindjet tua. Dhe kjo doli e vërtetë, sepse pushteti ia ndryshoi kryeministrit bindjen. E kishte kauzë të rëndësishme demarkacionin, por në momentin që lidhi paktin me Hashimin, kjo nuk bëri më problem. Kauza nuk mbeti e njëjtë", është shprehur Konjufca.

EPOKA ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 21 SHKURT - Më në fund, tre vjet pas nënshkrimit të marrëveshjes së demarkacionit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi, ky dokument pritet të ratifikohet sot (enjte) në Kuvendin e Kosovës. Kryesia e Kuvendit të Kosovës, në mungesë të Listës Serbe, ka miratuar të mërkurën kërkesën e kryeministrit Ramush Haradinaj për seancë të jashtëzakonshme për ratifikimin e demarkacionit. Seanca plenare për demarkacionin është caktuar sot në orën 11:00.

Bashkë me Projektligjin nr. 06/L-060 për ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të

Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi do të votohet edhe raporti i komisionit të ri për kufirin dhe deklarata e përbashkët për këtë çështje e nënshkruar nga presidentët e të dy vendeve.

Partnerët e koalicionit qeverisës dhe LDK-ja kanë bërë me dije se do ta votojnë këtë marrëveshje, kurse Lëvizja Vetëvendosje ka paralajmëruar votën e saj kundër. Një ditë para se kjo marrëveshje të votohet, ambasadori amerikan në Kosovë, Greg Delawie, dhe shefja e Zyrës së BE-së, Natalia Apostolova, janë siguruar për votat e demarkacionit, duke i takuar shefat e grupeve parlamentare të subjekteve politike.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka



Ambasadori Delawie dënon rastin e kërcënimit të pjesëtarëve serbë të FSK-së

PRISHTINË, 21 SHKURT - Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në Zubin Potok, të cilëve përmes një letre u është kërkuar të mos jenë pjesë e kësaj force. "Të

gjithë qytetarët e Kosovës meritojnë të drejtën për të qenë të sigurt gjatë jetesës së tyre duke shkuar në punë. Ne i dënojmë kërcënimet kundër anëtarëve të FSK-së në Zubin Potok dhe u bëjmë thirrje autoriteteve për hetim të plotë. Ne mbështesim integritetin e serbëve të Kosovës në të gjitha institucionet e Kosovës", ka shkruar Delawie në llogarinë e vet në "Twitter".

gjinë e serbëve të Kosovës në të gjitha institucionet e Kosovës", ka shkruar Delawie në llogarinë e vet në "Twitter".

Flet për "Epokën e re", Lutfi Haziri

Me ratifikimin e demarkacionit, K

Nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lutfi Haziri, ka bërë me dije se deputetët e kësaj partie janë unikë në votën për Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes së kufirit ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se nëse demarkacioni nuk ratifikohet, Kosova e humbet çastin e fundit për ta marrë liberalizimin e vizave. Haziri ka folur edhe për dialogun me Serbinë, duke bërë me dije se ky proces do të mbyllet me një rol aktiv të LDK-së. Ai ka thënë se nuk mund të ketë kurrfarë rezultati të pritur dhe përfundim të dialogut pa përfshirjen e të gjithë aktorëve kryesorë në Kosovë, do të thotë edhe përfshirjen e opozitës

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 21 SHKURT -

"Epoka e re": Z. Haziri, të enjten pritet të mbahet seanca e jashtëzakonshme për ratifikimin e marrëveshjes për shënimin e kufirit ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi. Grupi parlamentar i LDK-së ka konfirmuar votën unanime për këtë marrëveshje. Cila është arsyeja që do të votoni për ratifikimin e demarkacionit?

Haziri: Ne si LDK Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi e shohim dhe e lexojmë si projektligjin e gushtit të vitit 2015, sepse nuk ka ndryshime në këtë projektligj. Pra, është i njëjti projektligj. Prapashtesat si aneks deklarata nuk kanë kurrfarë impakti të drejtpërdrejtë në projektligj. Kjo më shumë ka krijimin e një ambienti politik sesa që bëhet fjalë për diçka tjetër. Kështu që, LDK-ja në interes të republikës, në veçanti në interes të qytetarëve të saj, të enjten ose kurdo që partnerët e koalicionit apo koalicioni i pushkëve i mbledh votat, LDK-ja do ta mbështetë këtë projektligj.

"Epoka e re": LDK-ja ka tejkaluar interesat partiake dhe inatet për ta votuar këtë projektligj, ani pse pikërisht për këtë çështje është rrëzuar Qeveria Mustafa nga këta që sot po e mbështesin demarkacionin.

Haziri: Kjo nuk është hera e parë. LDK-ja ka bërë kompromise të dhimbshme shumë herë brenda këtyre 19 vjetëve të lirisë së Kosovës në emër të pajtimit dhe në emër të interesit kombëtar. Këtë herë, përtej kauzave të rrejshme politike dhe përtej proceseve të imponuara politike, LDK-ja silltet me racionalitet si parti shtetformuese dhe konfirmon vullnetin qytetar. Si partia më e

madhe me votë politike që kemi dalë në zgjedhjet e fundit, sillmi me përgjegjësi dhe me urtësi. Grupi ynë parlamentar do të jetë përfundimisht unik. Nuk ka qenë unik në kohën kur Isa Mustafa ka qenë sponsor i këtij projektligji, por po bëhemi unik në kohën kur z. Haradinaj është kryeministër dhe kur LDK-ja është në opozitë duke dëshmuar se si opozita duhet të silltet karshi interesave të qytetarëve.

"Epoka e re": Ky veprim i LDK-së duhet ndjekur edhe nga partitë e tjera?

Haziri: Çdo parti në pozitë apo në opozitë duhet të silltet me racionalitet dhe të votojë në interes të shtetit, edhe atëherë kur nuk vlerësohet si votim i popullarizuar. Interesi qytetar është mbi të gjitha. Ky është mësim edhe për disa deputetë që vendimet mund të vonohen, por prapë duhet të votohen. Edhe ata deputetë që e kanë vonuar këtë proces për gati tre vjet duhet ta shohin se si LDK-ja me racionalitet dhe me largpamësi që nga dita e parë ka kërkuar që ky proces të përballohet dhe të përfundohet në mënyrën më të mirë, sepse është në interes të qytetarëve të Kosovës. Për të mos u mbajtur edhe më tutje qytetarët e Kosovës të izoluar, duhet të ratifikohet marrëveshja për demarkacionin.

"Epoka e re": Pas miratimit të projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes për shënimin e kufirit me Malin e Zi, besoni se qytetarëve të Kosovës do t'u liberalizohen vizat?

Haziri: Në vitin 2006 kam qenë zëvendëskryeministri i parë i Kosovës që është marrë me integritime evropiane dhe që procesin e integritimeve e kam kosovarizuar. Nëse flasim 12 vjet pas, do të thotë aspirata jonë për procesin e integritimeve



evropiane dhe liberalizimi i vizave ka qenë gjithmonë i kushtëzuar me procese të tjera politike. Fillimisht me statusin e Kosovës, pastaj ka qenë i lidhur me normalizimin e raporteve me Serbinë, si dhe me ratifikimin e marrëveshjes së kufirit me Malin e Zi. Tani kushte mbeten sundimi i ligjit dhe lufta kundër kimit dhe korrupsionit. Qytetarët e Kosovës janë mbajtur të izoluar në këtë fazë për shkak të një vendimi i cili është tash e tri vjet, që nuk ka asnjë problem territorial. Pra, ky është absurd i llojit të vet. Qytetarët janë mbajtur të izoluar në mënyrë të padrejtë për një kohë të gjatë, për nëntë vjet nga mosqartësia e politikave të BE-së, ndërsa për tre vjet po mbahen nga politikanët e Kosovës, të cilët nuk e kanë të qartë ecjen e vet politike. Prandaj, është javë kritike që ky proces të kalohet sepse do të ketë mundime

shtesë nga pesë vendet anëtare të BE-së prej të cilave, Spanja nuk i ka njohur ende dokumentet e udhëtimit të Kosovës. Do të ketë negociata shtesë me vendet e shengenit që nuk janë pjesë e BE-së. Po ashtu, do të ketë bisedime me vendet anëtare të BE-së që kanë frikë nga lëvizja masive e kosovarëve drejt Perëndimit pas liberalizimit të vizave. Këto probleme duhet t'i qartësojmë para se të na hiqen vizat. Diplomacia e Kosovës duhet të veprojë shumë në mënyrë që të arrihet një afat optimal për caktimin e datës për liberalizimin e vizave.

"Epoka e re": Keni optimizëm se liberalizimi do të mund të ndodhë në pjesën e dytë të këtij viti?

Haziri: Nëse demarkacioni nuk ratifikohet këtë javë, Kosova e humbet momentumin e fundit për ta fituar liberalizimin e

vizave, sepse pastaj evropianët janë në procese zgjedhore dhe minimumi i asaj që duhet për një normalitet brenda BE-së pas zgjedhjeve janë gjashtë muaj. Nëse merret parasysh se po rritet populizmi, ksenofobia dhe lufta kundër emigrantëve në disa shtete të Evropës, atëherë komplikimet mund të jenë shtesë karshi Kosovës si vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor që nuk ka liberalizim të vizave.

"Epoka e re": Z. Haziri, si e keni parë kërkesën e pushtetit për përfshirjen e opozitës në procesin e dialogut me Serbinë?

Haziri: Nuk mund të ketë kurrfarë rezultati të pritur dhe përfundim të dialogut pa përfshirjen e të gjithë aktorëve kryesorë në Kosovë, që nënkupton edhe përfshirjen e opozitës. LDK-ja nuk është vetëm opozitë, por është parti historike e këtij

Kosova zë hapin e fundit për vizat



vendi, e cila në çdo proces politik e ka pasur rolin e vet. Nuk mund të ketë proces në vend pa fjalën e LDK-së, pa pjesëmarrjen dhe qëndrimin e saj. Pa LDK-në në këtë vend nuk mund të vendoset asgjë. Kështu që, edhe ky proces pritet të mbyllet me një rol aktiv të LDK-së, i cili do të qartësohet pas përfundimit të procesit të shumëpritur të liberalizimit të vizave.

"Epoka e re": *Është e gatshme LDK-ja ta japë kontributin e vet në dialogun Kosovë - Serbi?*

Haziri: Nuk ka të bëjë me gatishmëri. Nuk mund të vazhdojmë një proces të rëndë politik pa e pasur të qartë agjendën dhe orarin. Ne kemi sponsorizuar rezolutën e Kuvendit të Kosovës për negociatat me Serbinë dhe vazhdimi i këtij dialogu do ta ketë mbikëqyrjen parlamentare. Shumë shpejt dialogut me Serbinë do t'i vihet një qartësi. Do të ketë një riformatim, një rishikim të agjendës dhe një orar më të saktë me tema më të qëndrueshme lidhur me përmbylljen e këtij procesi. Nuk mund të flasim më për një vazhdimësi të këtij procesi pa orar, por për një mbyllje të procesit që pritet të ndodhë në Bruksel.

"Epoka e re": *Në strategjinë e BE-së për vendet e Ballkanit Perëndimor është paraparë arritja e një marrëveshje obliguese në mes të Kosovës dhe Serbisë për normalizim të raporteve deri në vitin 2019. Ka qenë kjo një impuls shtesë për LDK-në që të jetë pjesë aktive e dialogut?*

Haziri: Kjo nuk ka të bëjë vetëm me Kosovën. Në dokumentin e

BE-së për perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor ka edhe kushte të tjera, por ne nuk po i lexojmë. Është kushti i kufirit në mes të Shqipërisë dhe Greqisë, është kushti i Maqedonisë për të ecur përpara për emrin në raport me Greqinë, është kushti i Serbisë drejt normalizimit dhe njohjes së Kosovës. Ky dokument ka perspektivë, por Kosova është më mbrapa. Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor janë shumë të kushtëzuara për të ecur përpara dhe kushtëzimi është i lidhur me njëra-tjetrën. Vendet e Ballkanit Perëndimor janë të lidhura në mënyrë zinxhimore, kështu që efekti i kësaj ka me qenë domino ose kanë për të ecur përpara të gjitha vendet ose kanë për të rënë të gjitha.

"Epoka e re": *Z. Haziri, jeni të kënaqur me rolin e LDK-së si parti opozitare?*

Haziri: Aktualisht jemi të hendikepuar për shkak se kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, është në rehabilitim shëndetësor. Kemi besim se shumë shpejt kryetari Mustafa do t'i kthehet familjes, LDK-së dhe jetës politike në Kosovë. Ai ka lënë një zbrazëturë politike edhe më tutje të pazëvendësueshme, por pjesa tjetër është funksionale. E përmenda këtë vetëm si rrugë të punës, sepse LDK-ja silltet me racionalitet politik dhe me dinamikë politike që unë e përshkruaj se asnjëherë nuk ngutemi, por asnjëherë nuk vonohemi. Kjo është rruga dhe ritmi që LDK-ja e mban. Me rikthimin e kryetarit Mustafa, LDK-ja do ta ketë një dinamikë të re të punës si opozitë.

Pacolli merr përkrahjen e Zvicrës

PRISHTINË, 21 SHKURT (ER) - Zëvendëskryeministri i parë i Qeverisë së Republikës së Kosovës, njëherësh ministër i Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli, ka takuar të mërkurën në Prishtinë zëvendëssekretaren e shtetit të Zvicrës, Krystyna Marty Lang, me të cilën ka diskutuar për bashkëpunimin dypalësh dhe për iniciativë të reja për shtimin e këtij bashkëpunimi.

Pacolli gjatë këtij takimi ka falënderuar Zvicrën për mbështetjen që po vazhdon t'ia japë Kosovës. "Ne e falënderojmë Zvicrën që e ka mbështetur historikisht Kosovën. Ish-presidentja e Zvicrës, Micheline Calmy Rey, ka bërë thirrje që herët, që Kosova të bëhet

e pavarur dhe ajo e ka vendin në historinë moderne të Kosovës", ka thënë Pacolli. Ai e ka njohur bashkëbiseduesen edhe me zhvillimet e fundit në Kosovë në lidhje me Dhomat e Specializuara, Projektligjin për demarkacionin etj. Diplomati e lartë zvicerane, e shoqëruar nga ambasadori i Konfederatës Helvetike në Kosovë, Jean-Hubert Lebet, ka konfirmuar vullnetin e Zvicrës për ta vazhduar ndihmën e fuqishme. Duke folur për bisedimet me Serbinë, ajo ka shtuar se Zvicra kundërshton çdo ide shkëmbimi terriore në Ballkan. Ky qëndrim u mbështet nga ministri Pacolli, i cili tha se kjo ide do të ishte si të hapej "Kutia e Pandorës" në rajon.



Kosova ka ndërmarrë hapa konkretë për ndaljen e migrimit

PRISHTINË, 21 SHKURT (ER) - Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, njëherësh koordinator nacional për migrim, Izmi Zeka, ka pritur të mërkurën në takim Astrid Ziebarth nga Fondi Gjerman Marshall i Shteteve të Bashkuara. Sipas një njoftimi të MPB-së, në këtë takim u diskutua lidhur me trendët e migrimit në Kosovë që nga viti 2015, si dhe me sfidat e menaxhimit të migrimit dhe emigrimit, zbatimin e strategjisë për migrim etj.

Zëvendësministri Zeka ka njoftuar Ziebarth lidhur me trendët



e migrimit, ku u potencua fakti se Kosova nuk është prekur nga ndonjë fluks i madh në vitin 2015, siç ndodhi me vendet e tjera të rajonit. Ai ka theksuar se janë ndërmarrë hapa konkretë që në raste të fluksit do të menaxhohet sa më mirë, duke hartuar planin e reagimit për menaxhimin e fluksit masiv me migrantë dhe refugjatë. Në këtë takim u bë me dije edhe rreth planeve për hartimin e strategjisë së re pesëvjeçare lidhur me migrimin, proces ky që do të përfundojë deri në fund të këtij viti.

Haradinaj: Romët dhe ashkalinjtë të jenë të barabartë në jetën shoqërore e politike

PRISHTINË, 21 SHKURT (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë të mërkurën në seminarin e organizuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit, në bashkëpunim me Zyrën e Komisionit Evropian, me temën "Zotimi i politikave dhe përfshirja e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë e Kosovës".

Qëllimi i këtij seminary ishte diskutimi rreth të arriturave, sfidave dhe prioriteteve për zbatimin e politikave për komunitetet rom dhe ashkali në Kosovë, siç janë: arsimit, punësimi, mirëqenia sociale, shëndetësia, banimi, regjistrimi civil dhe tema të tjera që janë të ndërthurura me diskriminimin dhe barazinë gjinore. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj, pasi ka shprehur falënderimin e veçantë për bes-



imin që të zgjedhurit nga ky komunitet i kanë dhënë atij, ka thënë se mësimet e nxjerra nga e kaluara, qofshin të vuajtjeve,

të gabimeve, duhet të shërbejnë për të qenë më vizionarë. "Ky vizion nënkupton që ne të arrijmë që romët, ashkalinjtë e

Kosovës të jenë të barabartë, aktivë, pjesëmarrës në jetën shoqërore dhe politike", ka deklaruar Haradinaj.

Përmbillet gara me tabela në 250 shkolla të Kosovës

PRISHTINË, 21 SHKURT (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi dhe ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt, kanë marrë pjesë në ceremoninë përmbilte të garës me tabela, e cila është zhvilluar në rreth 250 shkolla të Kosovës. Kjo garë është zhvilluar në kuadër të projektit për arsim të GIZ-it gjerman dhe fushatës së MASH-it për një arsim më të mirë që po zhvillohet me moton "Arsimi në dorën tënde".

Me këtë rast ministri Bytyqi, duke uruar shkollat fituese të këtyre tabelave, ka thënë se pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja në arsim është objektiv i parë i "Planit Strategjik të Arsimit të Kosovës 2017-2021". "Kjo është një nga themelet e krijimit të një shoqërie me mundësi të barabarta për të gjithë dhe për shfrytëzimin e potencialit më të mirë të të gjithëve në funksion



të zhvillimit të vendit", ka thënë ai, duke theksuar se kurrikula e re arsimore ka një qasje gjithëpërfshirëse me nxënësin në qendër, e cila promovon

mundësi të barabarta. Duke folur për mbështetjen dhe bashkëpunimin me GIZ-in, ministri Bytyqi ka thënë se janë të hapur për bashkëpunim me

të gjithë partnerët tanë ndërkombëtarë. "Mbetemi të angazhuar së bashku për një arsim cilësor në Kosovë", ka thënë Bytyqi.

NGJARJE NGA RAPORTI I POLICISË



Tre në pranga për prostitucion

GJAKOVË, 21 SHKURT - Dy femra dhe një mashkull janë arrestuar në Gjakovë pasi të njëjtit janë marrë me prostitucion. Policia ka njoftuar se si prova materiale janë konfiskuar tre telefona mobilë. Me vendim të prokurorit dy të dyshuarat janë dërguar në mbajtje, ndërsa i dyshuari i tretë është liruar në procedurë të rregullt.

Arrestime për posedim narkotikësh

GJILAN, 21 SHKURT - Në Gjilan dhe në Ferizaj Policia e Kosovës ka arrestuar dy shtetas tek të cilët gjatë kontrollit janë gjetur sasi narkotikësh, të llojit marijuanë. Një nga të arrestuarit, me vendim të prokurorit, është liruar në procedurë të rregullt, ndërsa tjetri është dërguar në mbajtje.

Për posedim armësh pa leje, pesë persona në pranga

PRIZREN, 21 SHKURT - Policia e Kosovës në dy raste të ndara ka prangosur pesë persona, pasi atyre u janë gjetur në posedim armë zjarri për të cilat nuk kanë pasur leje. Dy nga ta janë arrestuar në Prizren, ndërsa tre të tjerë në Mitrovicën e Jugut dhe me vendim të prokurorit, që të gjithë janë dërguar në mbajtje.

Rrahje masive në Pejë

PEJË, 21 SHKURT - Pas një mosmarrëveshje, katër meshkuj shqiptarë janë përfshirë në rrahje mes vete në Pejë, me ç'rast të gjithë të përfshirit kanë pësuar lëndime trupore dhe janë dërguar për tretman mjekësor. Në lidhje me rastin, i cili ka ndodhur të martën mbrëma në rrugën "Selman Lajqi" në orën 21.00, janë arrestuar tre prej tyre dhe me vendim të prokurorit, dy nga të dyshuarit janë dërguar në mbajtje. I dyshuari i tretë vazhdon tretmanin mjekësor dhe njësitë policore janë duke e hetuar rastin.

Përmbillet projekti i binjakëzimit "Përkrahja e mëtejme për Kuvendin e Kosovës"

Veseli: Kosova, e përkushtuar për përmbushjen e vizionit për të qenë pjesë e BE-së

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka theksuar se Republika e Kosovës mbetet plotësisht e përkushtuar për përmbushjen e vizionit të qytetarëve të saj për të qenë pjesë e Bashkimit Evropian

EPOKA
ERE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 21 SHKURT - Në Kuvendin e Kosovës të mërkurën është zhvilluar ceremonia e përmbiljes zyrtare të projektit të binjakëzimit "Përkrahja e mëtejme për Kuvendin e Kosovës", projekt ky i financuar nga BE-ja, menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, ndërsa i implementuar nga Kuvendi Kombëtar i Hungarisë. Sekretari i përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, ka bërë një elaborim të të gjithë

projektit dhe ka shpalosur efektet mjaft pozitive të tij për ngritjen e kapaciteteve të Kuvendit. "Ky projekt i binjakëzimit kishte mision strategjik të ndihmojë në ndërtimin e një parlamenti funksional në Kosovë si dhe për ngritjen e strukturave dhe të procedurave të nevojshme për një proces të suksesshëm të integrimit në BE, me vëmendje të veçantë në Marrëveshjen për Stabilizim Asociim (MSA)", ka thënë Krasniqi. Ndërkaq kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, këtë ditë e ka konsideruar të veçantë për Kuvendin e Kosovës pasi, sipas

tij, pas një pune intensive dy-jeçare, po përmbillet me sukses ky projekt, nëpërmjet të cilit Kuvendi i Kosovës ka hedhur një hap të rëndësishëm në fushën e reformave institucionale e ligjore, në funksion të procesit të integrimit evropian të vendit tonë. "Falënderojmë Bashkimin Evropian për mbështetjen e këtij projekti dhe Parlamentin e Hungarisë për implementimin e tij! Të gjitha fushat, në të cilat është zbatuar ky projekt, janë të rëndësishme vendimtare për avancimin e këtij procesi", është shprehur kryeparlamentari Veseli. Kreu i Kuvendit ka theksuar se Republika e Kosovës mbetet plotësisht e përkushtuar për përmbushjen e vizionit të qytetarëve të saj për të qenë pjesë e Bashkimit Evropian.

Nënkryetari i Kuvendit Kombëtar të Hungarisë, Istvan Jakab, ka theksuar se për Hungarinë është kënaqësi ta ndihmojë Kosovën në rrugën drejt Bashkimit Evropian. "Mendoj se njëjtë sikurse dy projektet e mëhershme, janë arritur rezultate pozitive. Kemi pasur bashkëpunim të mirë me ju, sepse kemi ndjekur linjën e detyrave. Qëllimi ynë ka qenë ta dizajnojmë një zgjedhje që u përshtatet nevojave të Kosovës dhe kjo më së miri dëshmohet nga plani i veprimit", ka thënë Jakab, duke shtuar se Kosova duhet të tregojë se është vend që mund t'i besohet. "Çështjet që kanë mbetur të hapura duhet të zgjidhen dhe kjo është e vetmja mënyrë se si ju mund të integrohemi në Evropë", ka thënë nënkryetari i Kuvendit

hungarez.

Shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Nataliya Apostolova, ka deklaruar se strategjia e Bashkimit Evropian, e publikuar në shkurt, cek prioritetet, rrugën që duhet ta kalojnë vendet që aspirojnë integrimin dhe reformat e nevojshme. Në këtë aspekt ajo ka thënë se barra kryesore do t'i bjerë Kuvendit, i cili, sipas saj, duhet të ndërtojë konsensus ndërmjet partive politike. "Ne do të vazhdojmë ta mbështesim Kuvendin e Kosovës dhe do ta vëzhgojmë zbatimin e rekomandimeve", ka thënë Apostolova.

Po me një fjalë rasti të pranishmëve iu drejtua edhe Zoltan Horvath, drejtues i Ekspertit të Asistencës Teknike të Kuvendit Kombëtar të Hungarisë.



Veseli, afat deputetëve: Shqyrtojini të gjitha ligjet deri më 31 mars



PRISHTINË, 21 SHKURT (ER) - Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, ka thënë se deri më 31 mars të këtij viti deputetët e Kuvendit duhet ta përfundojnë shqyrtimin e të gjitha ligjeve në kuadër të agjendës së reformave evropiane (ERA). Këtë deklaratë Veseli e dha të mërkurën gjatë takimit me kryetarët e komisioneve par-

lamentare. "Kuvendi i Kosovës do të vazhdojë të shtojë punën e vet, me qëllim të shtyrjes përpara të shumë reformave të rëndësishme për vendin. Me kryetarët e komisioneve parlamentare diskutuam punën e bërë deri më tani, njëherësh kërkova nga ta të punojnë edhe më shumë për përmbushjen e

agjendës legislative, për mbikëqyrjen e punës së ekzekutivit dhe një monitorim më të shpeshtë në terren për zbatimin e ligjeve. Në veçanti kërkova që deri më 31 mars të këtij viti të përfundojë shqyrtimi i të gjitha ligjeve në kuadër të agjendës së reformave evropiane (ERA)", ka thënë Veseli.

Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka vizituar Odën Ekonomike të Kosovës (OEK)

Vlera e lirimeve nga tatimi doganor për lëndën e parë është mbi 357 mijë euro

Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka thënë se vlera e lirimeve nga tatimi doganor për lëndën e parë ka arritur vlerën e 357,605.86 euro. Sipas tij, nga lirimi i TVSh-së për lëndë të parë bizneset kanë përfituar 2.9 milionë euro. Po ashtu, lirime nga tatimi i akcizës për lëndët ndihmëse arrijnë vlerën 1.2 milion euro, kurse për pajisje të IT-së 50 000 euro

EPOKA E RE**Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 21 SHKURT - Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka vizituar të mërkurën Odën Ekonomike të Kosovës (OEK), ku është pritur nga kryetari Safet Gërxhaliu. Në këtë takim u diskutua për avancimin e dialogut publiko-privat dhe kontributin e këtij dialogu në politikat fiskale.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu, ka falënderuar ministrin Hamza për gatishmërinë e bashkëpunimit me institucionin që ai e drejton. "Si Odë Ekonomike e Kosovës fuqishëm i mbështesim reformat ligjore që paraqesin siguri juridike qoftë për bizneset vendore, por edhe për investitorë të huaj. Është e dëmshme të mbështetën iniciativa ligjore

nga grupe të ndryshme vetëm për përfitime politike apo për mbrojtjen e interesave të grupeve të caktuara", ka thënë Gërxhaliu. Sipas tij, politizimi i proceseve reformuese e dëmton Kosovën qoftë në aspektin ekonomik, juridik por edhe në imazh. "Duhet të mbështeten reformat që bazohen në dialog dhe partneritet. Me Ministrinë e Financave kemi ndërtuar qasje që legjislacioni të jetë në funksion të zhvillimit, në veçanti të sektorit privat si garanci e stabilitetit politik, social dhe integruës. Kjo, para së gjithash, do të ndikojë në përmirësimin e imazhit ashtu të dëmtuar të Kosovës", ka deklaruar Gërxhaliu.

Kurse ministri i Financave, Bedri Hamza, ka prezantuar efektet e implementimit të poli-

tikës fiskale, ligjet tatimore që janë në procedurë dhe themelimin e grupit të përbashkët të punës për masat mbrojtëse tatimore për prodhuesit vendorë. Ai ka thënë se ky angazhim 45 ditore i implementimit të politikës fiskale solli 150 vendime të zgjedhura, 50 kërkesa në shqyrtim dhe 80 kërkesa të tjera që do të shqyrtohen për lehtësime tatimore në dinamikë kohore shumë të shpejtë. "Nga tatimi doganor për lëndën e parë janë liruar 357,605.86 euro vlerë, ndërsa nga TVSh-ja për lëndë të parë janë liruar 2.9 milionë euro, ndërsa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ka pasur afër 1.3 milion euro. Dhe, siç shihet, ka një rritje prej 1.7 milion eurosh më shumë lirime krahasuar me vitin paraprak. Kjo dëshmon se kemi shtim të

prodhimtarisë vendore", ka thënë Hamza, duke shtuar se linja të prodhimit të liruar nga tatimi doganor dhe TVSh-ja janë në vlerë 561,982 euro, ndërsa lirime nga tatimi i akcizës për lëndët ndihmëse janë afër 1.2 milion euro, si dhe pajisje të IT-së prej 50.000 eurosh.

Ministri Hamza ka thënë se qëllimi i tyre është t'i bëjnë ndryshimet e duhura në të mirë të biznesit. "Qëllimi ynë është që këto ligje të kenë një qëndrueshmëri më të gjatë dhe të jenë në kuadër të dispozitave të fundit të direktivave të BE-së. Implementimi i këtyre ligjeve paraqet një siguri të madhe për investitorët tanë dhe të huaj", ka deklaruar Hamza, duke shtuar se objektivi ka zhvillimin e sektorit privat.



Ministrja Reshitaj dhe ambasadori sloven biseduan për mbrojtjen e mjedisit

PRISHTINË, 21 SHKURT - Ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, ka pritur të mërkurën në takim ambasadorin e Slovenisë në Kosovë, Bojan Bertoncej. Në takim e parë njoftues ministrja Reshitaj, pasi ka falënderuar shtetin sloven për përkrahjen dhënë Kosovës, ka prezantuar prioritetet e saj në ministrinë që ajo drejton. "Menaxhimi i duhur i mbeturinave, krijimi i zonave të reja të gjelbra, mbrojtja dhe rreg-

ullimi i shtretërve të lumenjve e burimeve ujore, reduktimi i ndotjes së ajrit si dhe krijimi i një planifikimi të duhur hapësinor, janë disa nga prioritetet e mia si ministre", ka thënë ministrja Reshitaj. Ndërkaq ambasadori sloven, pasi ka përgëzuar ministrin për angazhimin e saj në zgjidhjen e problemeve mjedisore, u shpreh se shteti që ai përfaqëson është shembull i trajtimit dhe menaxhimit të duhur të mbeturinave, ujërave të zeza etj. "Ne do ta

përkrahim Kosovën dhe juve si ministri në rrugën tuaj të zhvillimit të vendit, mbrojtjes dhe përmirësimit të gjendjes së mjedisit", ka potencuar ambasadori sloven. Ministrja Reshitaj e ka vlerësuar shumë të rëndësishëm bashkëpunimin me shtetin sloven në të gjitha fushat, me theks të veçantë në shkëmbimin e përvojave të menaxhimit të duhur të mbeturinave, për mbrojtjen e burimeve ujore, trajtimin e ujërave të zeza etj.



Kosova prezantohet me 30 projekte në Samitin e Londrës

Javën e ardhshme do të mbahet Samiti i Londrës, i cili do t'i bëjë bashkë gjashtë kryeministrit e Ballkanit Perëndimor, me ftesë të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh). Kosova në këtë samit do t'i prezantojë mbi 30 projekte

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 21 SHKURT - Mbi 30 projekte janë seleksionuar për t'u prezantuar në Samitin e Londrës nga kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, javën që vjen. Samiti do të bëjë bashkë gjashtë kryeministrit e Ballkanit Perëndimor, me ftesë të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), derisa në vazhden e përgatitjeve, kryeministri Haradinaj ka zhvilluar një takim me drejtorin e Konsituencës në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), ku bën pjesë edhe Kosova, Ove Jensen, me të cilin u bisedua për projektet me të cilat prezantohet Kosova dhe për lehtësimin e procedurave administrative deri te financimi i tyre nga ana e BERZH-it. "Jemi të

përkushtuar si Qeveri që ta vazhdojmë punën dhe në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësuesit e bizneseve dhe sektorin privat, t'i japim kahe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të Kosovës. Për disa muaj ne kemi punuar ngushtë me të gjithë aktorët nga sektori privat dhe publik që t'i zgjedhim projektet më të mira, më të nevojshme për t'u prezantuar në Samit", ka thënë kryeministri Haradinaj.

Roli i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) në Kosovë është mjaft i rëndësishëm për mbështetjen e vazhdueshme që ka dhënë dhe vazhdon të japë ky institucion financiar ndërkombëtar, për çfarë kryeministri Haradinaj i falënderoi duke shprehur përkushtimin e Qeverisë së Kosovës për bashkëpunim edhe



në të ardhmen.

Kryeministri Haradinaj ka thënë se investimet e deritanishme të BERZH-it në Kosovë kanë dhënë rezultate. Ai ka theksuar rolin e Qeverisë për hartimin e politikave të favorshme për zhvillimin dhe fuqizimin e sektorit privat e që do të ndikojnë drejtpërdrejt edhe në hapjen e vendeve të reja të punës dhe një perspek-

tivë më të mirë ekonomike.

Koordinatori i BP6 (WB6) dhe Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC), Gazmend Abrashi, theksoi se për më shumë se katër muaj Qeveria ka pasur angazhim konkret për evidentimin dhe seleksionimin e këtyre projekteve, të cilat kalojnë vlerën e 500 milionë eurove, derisa projektet vijnë nga sektori

privat dhe ai publik dhe janë të shtrira në shumë komuna të vendit.

Ndërsa drejtori i BERZH-it, Ove Jensen, ka vlerësuar angazhimin e kryeministrit Haradinaj dhe të Qeverisë, duke i ofruar bashkëpunim të mëtutjeshëm, veçmas për lehtësimin e procedurave administrative për financimin e këtyre projekteve.

ARKEP-i nënshkruan memorandum bashkëpunimi me AEC-in maqedonas



PRISHTINË, 21 SHKURT (ER) - Kryetari i Bordit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), Kreshnik Gashi, ka nënshkruar të mërkurën memorandumin e bashkëpunimit ndërmjet Njësisë Nacionale për Siguri Kibernetike (KOS-CERT) si pjesë e ARKEP-it dhe Qendrës Nacionale për Reagim ndaj Incidenteve Kompjuterike (MKD-CIRT) si pjesë e Agjencisë për Komunikime Elektronike të Republikës së Maqedonisë (AEC).

Memorandumi i bashkëpunimit i nënshkruar ndërmjet dy institucioneve parasheh bashkëpunimin për trajtimin e incidenteve në hapësirën kibernetike, shkëmbimin e përvojave në fushën e sigurisë

kibernetike përmes programeve të trajnimit në dispozicion me qëllim të ngritjes dhe avancimit të stafit, si dhe t'i identifikojë mundësitë për shkëmbim akademik dhe bashkëpunim në kërkim dhe zhvillim.

Në takimin e mbajtur me rastin e nënshkrimit të memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet ekipeve nacionale CERT të Kosovës dhe Maqedonisë, kryetari i Bordit të ARKEP-së, Kreshnik Gashi dhe drejtori i AEC-ut, Sasho Dimitrioski, u kushtuan vëmendje të veçantë aktiviteteve të dy organeve rregullatore dhe ekipeve nacionale CERT në drejtim të përmirësimit të sigurisë kibernetike dhe koordinimit të aktiviteteve për mbrojtjen nga incidentet kibernetike.

BB-ja dhe GIZ-i vazhdojnë ta mbështesin ATK-në

PRISHTINË, 21 SHKURT - Drejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Sakip Imeri, ka pritur të mërkurën në takim një ekip nga Banka Botërore (BB) dhe zyrtarë nga organizata GIZ. Gjatë këtij takimi

është diskutuar për proceset aktuale në Administratën Tatimore dhe për objektivat në fushën e modernizimit të saj. Po ashtu, është diskutuar edhe për mundësinë e zhvillimit të programit të mbështetjes në fushën e

ngritjes së përmbushjes vullnetare të tatimeve dhe të bërit biznes në Kosovë. Programi i përkrahjes do të zhvillohet gjithsej në gjashtë faza, të cilat parashohin zbatimin e aktiviteteve specifike.



Veteranët e Prishtinës dhe Shpend Ahmeti, pro thellimit të bashkëpunimit

PRISHTINË, 21 SHKURT (ER) - Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së (Dega Prishtinë), Fatmir Sopi, bashkë me nënkryetarin Sali Vllahu dhe sekretarin Vehbi Hajzeri, kanë vizituar të

mërkurën Komunën e Prishtinës. Ata uruan kryetarin Shpend Ahmeti për fitoren e mandatit të dytë qeverisës si dhe shprehën vullnetin për thellimin e bashkëpunimit me komunën. Përgjatë

këtij takimi, kryetari Ahmeti ka theksuar se do të angazhohet që t'i ndihmojë maksimalisht kësaj organizate, me theks të veçantë për organizimin e shënimit të datave historike.




Andrin Kabashi boton veprën e dytë dramaturgjike

PRISHTINË, 21 SHKURT - "Engjëlli i vdekjes" është vepra e dytë dramaturgjike me radhë e poetit të ri, Andrin Kabashit. Kjo vepër është një dramë moderne me vetëm katër aktorë: tre meshkuj e një femër.

Në këtë vepër eksperimentet e personazhit, doktor Mengeles, ia zgjuan autorit kureshtjen mbi mutacionet gjenetike, edhe pse ai ishte një 'demon' për viktimat e tij. Kështu që, papritmas i lindi ideja Andrinut për ta shndërruar këtë shkencëtar 'të çmendur' në një qëllim për ta shkruar këtë dramë. "Dr. Mengele ishte i pari të cilit i erdhi ideja, të krijonte për herë të parë një klon. Synimet e tij ishin ta klononte liderin gjerman të asaj kohe, Adolf Hitlerin, ku pastaj, sipas pretendimeve të tyre, nazistët do të bëheshin të pamposhtur dhe do ta sundonin botën,

Hitleri do të rronte për jetë dhe nuk do të mund të kishte më ideologji të tjera që do ta kundërshtonin nazizmin, ashtu siç kanë menduar e mendojnë diktatorët gjatë gjithë historisë njerëzore. Dhe ashtu si poeti i Mesjetës së vonë dhe Renesancës së hershme, Dante Aligeri citon 'Rruga për në Parajsë fillon nga Ferri' është munduar që secili personazh të sillet rreth e qark rrethit të tij të ferrit, qoftë ai në rrethin e parë apo të shtatin, duke bërë që secili ndër ta, ta shprehë vetveten qoftë me anë të zënkave, që janë të shpeshta mes tyre, qoftë me anë të së kaluarës së hidhur, ku secili ndër ta tregon vuajtjet e tij në rrethin e tij të ferrit. Për ta pothuajse çdo ditë e jetës së tyre ish ferr", shkruan autori në parathënien e librit. Këtë dramë autori ua dedikon babë Shyqeriu, nënë Nexhmijes,



motër Abetares, vëlla Atdheut dhe dhjetëvjetorit të Pavarësisë

të Republikës së Kosovës. Andri vete më parë ka botuar

edhe dramën "Hakmarra".

tjetër

Ministria e Mjedisit, gjashtë projekte për Mitrovicën



MITROVICË, 21 SHKURT (ER) - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Albena Reshitaj, dhe deputeti i AKR-së, Islam Pacolli, janë pritur të mërkurën nga kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri. Gjatë këtij takimi Bahtiri e Reshitaj kanë nënshkruar një memorandum mirëkuptimi dhe bashkëpunimi për gjashtë projektet madhore që MMPH-ja do t'i realizojë në Mitrovicë. Bahtiri ka falënderuar ministren Reshitaj për implementimin e këtyre projekteve madhore në interes për qytetin e Mitrovicës,

duke vlerësuar lart punën e mirë që janë duke e bërë të gjithë ministrat nga radhët e AKR-së. Ndërsa ministria Albena Reshitaj ka folur për listën e projekteve që MMPH-ja do t'i realizojë në vitin 2018. Këto projekte, sipas saj, janë kopshti botanik, ujësjellësi Shipol-Brus, kanalizimi dhe ujësjellës të tjerë, kanalizimi në Frashër, rregullimi i shtratit të lumit Ibër, rregullimi i shtratit të lumit Sitnicë dhe ndërtimi i shtëpisë së peshkatarëve në liqenin akumulues në Suhadoll. Këto projekte arrijnë vlerën prej 2.5 milionë eurosh.

Studentët e Universitetit "Haxhi Zeka" presin përgjigje nga kryeministri dhe MASH-T-i

PRISHTINË, 21 SHKURT (ER) - Kryetarja e Parlamentit Studentor në Universitetin "Haxhi Zeka", Kaltrina Arifaj, muajin e kaluar ka

bërë një kërkesë te kryeministri dhe te MASH-T-i, së cilës ia ka bashkangjitur edhe 1 200 nënshkrime të studentëve në përkrahje të

iniciativës së saj që studentëve të këtij universiteti t'u ndahen bursa. Sipas Arifajt, studentët e këtij universiteti që katër vjet nuk kanë

marrë bursa. Ajo ka bërë me dije se ende nuk kanë marrë asnjë përgjigje konkrete nga kryeministri dhe as nga MASH-T-i.



"MENDIME TË ZGJEDHURA PËR ADEM DEMAÇIN" (10)

ADEM DEMAÇI, FIGURË UNIKE E HISTORISË SHQIPTARE**Selatin NOVOSELLA**

1209. Ramadan Musliu, shkrimtar: Adem Demaçi ofron një vizion të ri artistik

Romani i Adem Demaçit "Gjarpinjtë e gjakut" e abstrakton faktin se është një vepër e vënë ad acta, fakt ky që do ta mbante të tendosur kërshërinë e ushqyer me elemente jashtë artistike, po lexuesit i ofron një përjetim estetik, i ofron një botë artistike, i ofron një vizion të ri artistik.

210. Ramadan Pllana, veprimtar i çështjes kombëtare: Adem Demaçi, atdhetari më i devotshëm i kohës sonë

Duke e nderuar atdhetarin më të devotshëm të kohës sonë, Bacën Adem Demaçi, feniksin e ndërgjegjes sonë kombëtare, me rastin e 80-vjetorit të lindjes së tij, jo vetëm që i bëjmë nder personalitet të tij, por me këto manifestime i shërbejmë edhe kujtesës historike.

211. Ramadan Shala, bashkëveprimtar i Adem Demaçit: Adem Demaçi ka shkruar Programin dhe Statutin e "Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve"

Së bashku me Adem Demaçin, në vitin 1964, në Pejë, i kemi shkruar Programin dhe Statutin e organizatës "Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve". Unë kam përgatitur disa teza dhe kam ofruar disa statistika që janë përfshirë në Program, ndërsa Adem Demaçi me dorë i ka shkruar këto dy dokumente bazë të LRBSH-së.

212. Ramë Buja, ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës: Adem Demaçi, personalitet i pazëvendësueshëm

Adem Demaçi është caktuar nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së si njeriu më i gjetur, më i përshtatshëm për t'i bërë institucionet e përbashkëta në Prishtinë. Domethënë, insistohej nga Shtabi i Përgjithshëm që të krijohet një Asamble dhe të futen në të të gjitha subjektet politike dhe UÇK-ja. Adem Demaçi ka qenë një personalitet i pazëvendësueshëm dhe vetëm ai ka mundur ta kryej atë rol në atë kohë dhe askush tjetër.

213. Ramiz Kelmendi, shkrimtar: Me Adem Demaçin më ka lidhur gazetaria

Me Adem Demaçin më ka lidhur jeta publike, sidomos gazetaria, duke ia nisur në letrat shqipe që sot janë vepra.

214. Ramush Haradinaj, komandant i Zonës Operative të Dukagjinit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Për sakrificat e Adem

Demaçit kam mësuar qysh si fëmijë

Unë, qysh si fëmijë, kam mësuar për sakrificat e Adem Demaçit dhe për vitet e shumta që i ka kaluar në burg dhe çdo herë kam ruajtur një simpati për të. Pas çlirimit të Kosovës kam ndier obligim ta kem një takim me Bacën Adem, edhe për faktin se ai ishte një kohë Përfaqësues Politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që vepronte në Prishtinë.

215. Reshad popullor (shtator 1964): Adem Demaçi: "Lufta ime, gjithsesi, do të vazhdohet!"

Pas gjykimit të dytë të Adem Demaçit me 15 vite burg të rëndë, në vitin 1964, gjatë një pauze të këndimit, në një dasmë në Prishtinë, njëri prej rapsodëve, tregoi këtë anekdotë të krijuar për Adem Demaçin: "Në fjalën përfundimtare para Gjyqit në Prishtinë, Adem Demaçi ka thanë: 'Sa do që të më dënioni lufta ime për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë ka me vazhdu. Askush nëse nuk mbetet i gjallë në Kosovë, atë rrugë ka me e vazhdu një fëmijë jetim që ju ia keni vra babën, i cili e ka pi tamlin e një delje që ka kulot barin mbi varrin tim!'"

216. Rasim Selmanaj, kryetar i komunës së Deçanit: Adem Demaçi nuk e shiti shpirtin kurrë Adem Demaçi nuk i mësyu asnjëherë majat e pushtetit a të lartësisë së karriges, a të privilegjeve në kurriz të rrjetit, sepse ai ua kishte mësyre do lartësive të tjera, duke qëndruar gjithnjë në mrekullinë e thjeshtësisë së tij: në të hequrit dorë nga vetvetja për të mos krijuar mitin për vetveten a mitin e politikanit që shpesh e shet shpirtin e tij.

217. Resmije Kryeziu, shkrimtare: Duke e nderuar Adem Demaçin ne nderojmë veten tonë

Duke e nderuar Adem Demaçin ne e nderojmë veten tonë. Prandaj të mos habitemi me gjithë atë shumësi çmimesh, Dekorata, Mirënjohjesh dhe Falënderimesh që për të vijnë nga anë të ndryshme. Në këtë kontekst edhe Dekorata "Nderi i Kombit", bashkë me shtetësinë shqiptare, që iu dha nga Presidenti i Shqipërisë, Bamir Topi, ishte më shumë se nderim për Adem Demaçin, ishte vlerësim për gjeneratat e shumta atdhetare shqiptare.

218. Reshat Qahili, prorektor i Universitetit të Tetovës: Adem Demaçi "Doktor Honoris Causa" i Universitetit të Tetovës

Titulli "Doktor Honoris Causa" të Universitetit të Tetovës i jepet intelektualit, humanistit dhe atdhetarit të shquar, Adem Demaçi, për flijimin e tij deri në vetëmohim për çështjen kombëtare, për kontributin e jashtëzakonshëm prej humanisti dhe sendërtuesi të ideve universale demokratike, për sakrificën sublime për arsimin, kulturën dhe shkencën shqiptare.

219. Reshat Sahitaj, shkrimtar: Në mbrojtje të të drejtave të Adem Demaçit me shokë u organizuan shumë greva dhe protesta në Evropë

Nën ndikimin e Adem Demaçit dhe të patriotëve të tjerë që po vuanin dënimet e gjata në ish-Jugosllavi, u bë traditë të organizohen greva dhe protesta të ndryshme nëpër burgjet e pushtesit jugosllav, ku kërkohej përmirësimi i kushteve të jetës së të burgosurve politikë shqiptarë, e sidomos kthimi i tyre në burgjet e Kosovës.

220. Rexhep Qosja, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës: Krahasimi i Demaçit me Mandelën është i padrejtë për Demaçin

Adem Demaçin e krahasojnë me liderin jugafrikan Nelson Mandelën. Ky krahasim nuk më pëlqen, sepse është i padrejtë për Adem Demaçin. Nelson Mandela, megjithëse nën trysinë e dënimit me vdekje, ka bërë burgjet e Afrikës Jugore e kjo, megjithatë, domethënë në burgjet e anglezëve dhe holandezëve. Adem Demaçi, ndërkaq, ka bërë burg Serbie - burg serb dhe bolshevik!

221. Rexhep Selimi, komandant i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Adem Demaçi, figurë unike e historisë shqiptare

Adem Demaçi nuk është një figurë e rrallë, ai është, gjithsesi, figurë e veçantë dhe unike e historisë së re të shqiptarëve. Andaj, qysh i ri, jam frymëzuar për kohë të gjatë nga vepra e Adem Demaçit.

222. Robert Elsie, historian: Adem Demaçi, disidenti më i shquar politik në Jugosllavi

Adem Demaçi është figurë politike dhe aktivist i të drejtave të njeriut. Ai, në vitin 1953, studio letërsinë në Universitetin e Beogradit. Pas kthimit në Kosovë, punoi si gazetar në Shtëpinë Botuese "Rilindja". Në fund të viteve 1980, ai njihet si një prej disidentëve më të shquar politikë të Jugosllavisë.

223. Riçard Holbruk, ambasador i ShBA-ve në Organizatën e Kombeve të Bashkuara: Me Adem Demaçin, thënë troç, nuk mund të merremi vesh

E di mirë që Adem Demaçi është përfaqësues i UÇK-së këtu, në Prishtinë, por as unë, as ambasadori Hill, nuk mund të bëjë punë me të, por me Demaçin, thënë troç, ne nuk mund të merremi vesh. Prandaj, ju duhet të merrni përsipër këtë obligim dhe ta bindni Demaçin dhe UÇK-në se duhet ta pranojnë armëpushimin sepse, në të kundërtën, unë i kam duart e lidhura dhe s'mund të bëjë kurrfarë depërtimi.

224. Riza Greiçevci, shkrimtar: Adem Demaçi, legendë e gjallë e shqiptarëve

Më 17 gusht 1990, kur po shënohej përvjetori i rënies së simbolit të flamurit, Fazli Greiçevci, në vendlindjen e dëshmorit, erdhi Adem Demaçi, i cili para pak kohësh ishte liruar nga burgju i tretë, ku u pritë nga mijëra të pranishëm si legjendë e gjallë

shqiptare.

225. Rudi Berisha, poet: Adem Demaçi, faqe e historisë

Adem Demaçi është drita e cila po shkëputte me dhëmbë prangat jugosllave. Figura e tij është meteor liric, që në kazamatet serbe po ngrihej mbi zinxhirët pushtues. Demaçi është dhe do të mbetet faqe e historisë.

226. Rufi Osmani, kryetar i komunës së Gostivarit: Adem Demaçi, kurdoherë i dashur për popullin

Proza e Adem Demaçit sjell një vizion autorial, ku shkrihet historia, miti, legjenda, përvoja e vet autorit, theksimet e së kaluarës dhe tragjika e atyre viteve. Demaçi gjithnjë energjik, i paepur, i sinqertë por edhe i ashpër, sipas momentit dhe rastit, kurdoherë i dashur për popullin, të cilit shpeshherë ia qanë hallin, duke ia kujtuar vuajtjet shekullore.

227. Rushit Ramabaja, shkrimtar: Nën tonat ia këndonin foshnjave të tyre në djep: "Nina-nana në djep prej bredhit/Ti m'i ngjafsh, birë, Bacë Ademit!"

Dikur nënat iu këndonin foshnjave të tyre në djep: "Nina-nana në djep prej bredhit\ Ti m'i ngjafsh, birë, Bacë Ademit!". E nga ajo kohë ninullash s'kanë kaluar më shumë se dyzet e ca vjet. Domethënë, kur, veç të tjerash, Demaçi ishte ngujuar aty nga s'do të dilte më: në këngën e nënave, të atyre jetëdhënësive, që më mirë se askush, ruajnë kujtesën dhe dhimbjen e etnisë.

228. Rustem Mustafa, komandant i Zonës Operative të Llapit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Adem Demaçin e kemi përjetuar si udhëheqës tonin në përgjithësi Lirimin e Adem Demaçit nga burgju i tretë, në vitin 1990, tërë populli e ka pritë me gëzim, në veçanti ne të rinjtë, që në atë kohë mendonim se po bënim diçka më shumë se të tjerët, duke u organizuar në Lëvizjen atdhetare ilegale. Ne, atëherë, Bacën Adem e kemi përjetuar si udhëheqës tonin në përgjithësi.

229. Rrahim Sadiku, shkrimtar: Ndikimi i Adem Demaçit tek shqiptarët e Jugosllavisë ishte hyjnor

Ndikimi i jetës dhe veprës së Adem Demaçit në vetëdijen dhe në ndërdijen e shqiptarëve që jetonin atë kohë në Jugosllavi ishte, mund të thuhet lirisht, hyjnor. Ai ishte madhështia e të qenit shqiptar, ishte kuptimi i jetës së shqiptarëve, ishte Mesia.

230. Sabahajdin Cena, ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Pa Adem Demaçin dhe pa Adem Jasharin nuk mund të shkruhet historia jonë më e re

Adem Demaçi ishte shpresë dhe motiv për të gjithë ne. Prandaj, mund të vijmë në përfundim se pa Adem Demaçin dhe Adem Jasharin nuk mund të shkruhet historia jonë më e re. (Vijon)



BE-ja vazhdon sanksionet kundër zyrtarëve rusë

BRUKSEL, 21 SHKURT - Ambasadorët e Bashkimit Evropian kanë zgatur edhe për gjashtë muaj ngrirjen e aseteve dhe ndalimin e vizave për 150 zyrtarë rusë dhe separatistë ukrainas të mbështetur nga Moska. Diplomatat e BE-së, duke folur në kushte anonimiteti për "Radion Evropa e Lirë", kanë thënë se masa do të miratohet

edhe zyrtarisht në ditët vijuese. Ngrirja e aseteve dhe ndalimi i vizave janë vënë fillimisht ndaj këtyre personave, sepse janë konsideruar përgjegjës për cenimin e integritetit territorial të Ukrainës më 2014, pasi Rusia ka marrë nën kontroll Krimenë. Prej asaj periudhe sanksionet janë zgatur çdo gjashtë muaj. Diplomatat evropiane kanë

thënë se ambasadori i ri i Rusisë në ShBA, Anatoly Antonov, vazhdon të jetë në listën e sanksioneve. Rusë të tjerë të përfshirë në sanksionet e BE-së janë edhe zëvendëskryeministri Dmitry Rogozin, shefi i stafit të forcave të armatosura, general Valery Gerasimov dhe prezantuesi i televizionit shtetëror, Dmitry Kiselyov.



Pentagoni planifikon modernizimin e aftësive bërthamore

Pentagoni prezantoi këtë muaj një plan të ri bërthamor, i cili do ta modernizojë sistemin e mbrojtjes bërthamore nga ajri, toka dhe deti, ndërsa ka bërë dy ndryshime të arsenalit të tij bërthamor

WASHINGTON, 21 SHKURT - Rreth 30 vjet pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, mbrojtja nga armët bërthamore dhe politika e frenimit të kundërshtarit nga përdorimi i tyre janë rikthyer në qendër të vëmendjes. Pentagoni prezantoi këtë muaj një plan të ri bërthamor, që do ta modernizojë sistemin e mbrojtjes bërthamore nga ajri, toka dhe deti, ndërsa ka bërë dy ndryshime të arsenalit të vet bërthamor. Komponentët e arsenalit bërthamor nga ajri, toka dhe deti pritet ta arrijnë fundin e përdorimit të tyre në dekadën e ardhshme. Ekspertët thonë se

nëse Uashingtoni nuk vepron tani për ta modernizuar arsenalin, i gjithë synimi për frenimin e vendeve të tjera që të mos përdorin armë bërthamore mund të jetë në rrezik. "Ekziston mendimi se veprimet e Shteteve të Bashkuara mund të shkaktojnë një garë armatimi. Gara e armatimit aktualisht ekziston, por Shtetet e Bashkuara nuk po marrin pjesë në të", thotë Michaela Dodge nga Fondacioni Heritage. Analistët thonë se Rusia dhe Kina kanë 20 vjet që kanë filluar përmirësimin e programeve të tyre bërthamore. Një tjetër



rrezik është shfaqur - kërcënimin nga Koreja e Veriut dhe Irani që synojnë prodhimin e armëve bërthamore. Për t'i përballuar këto ndryshime, Pentagoni po bën thirrje për t'i shtuar dy armët e tjera arsenalit bërthamor amerikan. E para, është rikthimi në skenë i lëshimit nga deti të raketave të telekomanduar

me precizitet të lartë, aftësi që Amerika e kishte gjatë Luftës së Ftohtë. Aftësia tjetër, më pak e fuqishme, është lëshimi i raketave balistike nga nëndetëset. Ky element do ta bënte të pavlefshme idenë se kundërshtarja më e fortë bërthamore, Rusia, mund të përdorte armë më pak të fuqishme, për t'u

futur në një konflikt të vogël. "Do të preferoja të ktheheshim ku ishim dhjetë vjet më parë, kur të dyja palët po pakësonin rolin e armëve bërthamore në politikën e tyre të jashtme. Mendoj se Rusia nuk po na jep këtë mundësi tani, ndaj përkohehësisht ne duhet të jemi më bindës sesa do të preferoja", thotë Michael O'Hanlon nga Instituti Brookings. Strategjia bërthamore e administratës së ish-presidentit Obama në vitin 2010 parashikonte një ekuilibër delikat mes synimit përfundimtar për një botë pa armë bërthamore, duke mbajtur ende një arsenal të sigurt dhe të efektshëm. Varianti i administratës së presidentit Trump përqendrohet kryesisht te pika e dytë, për ta ruajtur arsenalin amerikan - duke vënë kontrollin e armëve në plan të dytë.

Merkeli: Maqedonia dhe Greqia, pranë zgjidhjes së kontestit të emrit



BERLIN, 21 SHKURT - Maqedonia është më afër se kurrë në dhjetë vjetët e fundit të zgjidhjes së kontestit të emrit të Greqinë, tha kancelarja gjermane Angela Merkel. "Jam shumë e kënaqur dhe e lehtësuar që ka lëvizje në bisedime", tha ajo në një konferencë me gazetarë në Berlin, së bashku me kryeministrin e

Maqedonisë, Zoran Zaev. Greqia refuzon ta njohë Maqedoninë me këtë emër, duke thënë se një gjë e tillë sugjeron se Shkupi ka pretendime territoriale ndaj një rajoni verior të Greqisë, i cili, po ashtu, quhet Maqedoni. Dy vendet, së voni, i kanë shtuar përpjekjet për zgjidhjen e kontestit. "Në dhjetë vjetët e fundit

zgjidhja nuk ka qenë kaq e afërt si tani dhe do të ishte e mrekulueshme nëse vështirësitë e mbetura tejkalohen", tha Merkel. Mosmarrëveshja ka penguar përpjekjet e Maqedonisë për t'u bashkuar me NATO-n dhe Bashkimin Evropian. Greqia është anëtare e të dyjave institucioneve.

Sloveni - Kroaci, përplasje për kufirin detar

LUBJANË, 21 SHKURT - Duket se po përshkallëzohet një tjetër tension mes të shumtëve që rrezikojnë stabilitetin dhe dialogun në Ballkan. Bëhet fjalë për mosmarrëveshjen mes Sllovenisë dhe Kroacisë, dy ish-republika jugosllave, të dyja anëtare të Bashkimit Evropian dhe aleancës së Atlantikut verior, mbi kufijtë detarë dhe të drejtat e lundrimit e peshkimit. Në qendër të mosmarrëveshjes është Gjiri i Piranos. Qeveria sllovene është ankuar për mungesën e disponibilitetit dhe

kompromiseve në negociatën nga Kroacia dhe kërcënon t'u drejtohet instancave kompetente të unionit, duke përmendur edhe nenetë të traktateve evropiane që në raste të caktuara mund të çojnë edhe në kërkesën për të pezulluar të drejtën e votës së Kroacisë në takimet e BE-së. Burime qeveritare nga Lubjana pohojnë se Zagrebi nuk pranon propozimin slloven për t'ia kaluar çështjen një gjykate ndërkombëtare arbitrazhi. Si pasojë, Lubjana kërcënon të

reagojë. Sipas kryeministrit slloven Miro Cerar, ekziston një vendim i dhënë vitin e kaluar nga Gjykata e Hagës, të cilit Qeveria e Zagrebit, e udhëhequr nga Andrej Plenkoviç, refuzon t'i bindet. Lubjana mund t'i drejtohet fillimisht Komisionit Evropian dhe, nëse brenda tre muajsh ai nuk reagon, Sllovenia mund të kërkojë një vendim të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Tensioni deri më tani ka qenë vetëm politik dhe verbal, por në shumë raste ka pasur fërkime në det mes anijeve të patrullimit.



Kumtesë e lexuar në konferencën shkencore "Veprimtaria atdhetare e Shotë Galicës" organizuar nga Instituti Albanologjik në 90-vjetorin e vdekjes së Shotë Galicës

LUFTA E SHOTË GALICËS DHE SHTETI SHQIPTAR



Afërdita DERVISHI

Përkufizimi

Kjo kumtesë është punuar mbi bazën e tri pyetjeve kërkimore:

1. Kush ishte Shotë Galica në Lëvizjen Kaçake dhe në lëvizjen çlirimtare?

2. Pse Shotë Galica zgjodhi rrugën më të vështirë të bërjes së lirisë, luftën?

3. Kush ishte Shotë Galica pas shkuarjes me jetimët e luftëtarëve të lirisë në shtetin shqiptar, të formuar nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër?

Përgjigjet në këto pyetje sugjестive mund të përkufizohen duke marrë për bazë faktet historike dhe përshkrimin e ngjarjeve të asaj kohe, kujtesën folklorike dhe popullore duke përdorur metodën e krahasimit përmes qasjes normative dhe teorisë epistemologjike, për ta hulumtuar origjinën, natyrën dhe ndjesinë njerëzore ndaj një miti që e ka krijuar kujtesa jonë historike, edhe për të shpëtuar nga kompleksi i inferioritetit kombëtar që kishin mbjellë qeveritë shqiptare pas shpalljes së pavarësisë e deri në vdekjen e saj, më 1927.

1. Shotë Galica në Lëvizjen Kaçake dhe në luftën çlirimtare

Shtëpisë së Halil Radishevës i lindi fëmija i shtatë. Prapë krisi pushka, siç e do zakoni kur lind djalë, por ky fëmijë i vogël ishte vajzë. Si për inat të zakonave, si për inat të mentalitetit, kjo vajzë, motër e gjashtë vëllezërve, me lavdinë e saj, bëri që të jetë shëmbëllimi dhe frymëzimi, që i bëhej krah djalit, burrit dhe vëllait, kudo që bëhej luftë për atdhe. Si për inat të historisë, që gjithmonë mbanë anën e burrave, kjo vajzë, Qerime Halil Radisheva, e njohur në histori me emrin Shotë Galica, do të bëhej simboli i rezistencës dhe simboli i trimërisë Shqiptare. Ajo, Shotë Galica e fitoi jo vetëm betejën morale por edhe betejën zakonore, me faktin se theu tabutë e kohës dhe të fesë.

Shote Galica, në vend të shtratit të nusërisë zgjodhi malin, në vend të kollanit të nusërisë zgjodhi gjerdanin me fishekë, në vend të fshesës zgjodhi koburen dhe në vend të miellit për të gatuar zgjodhi barotin për të luftuar. Jo shuplakë, por grusht u ra zakoneve, mentalitetit, të kohës dhe predikimeve të secilës fe. Kjo luftëtare e denjë mori pjesë në Kryengritjen e Rrafshit të Dukagjinit ndërsa në vitet 1922-1923 luftoi për mbrojtjen e 'Zonës neutrale' të Junikut, e cila shërbente si bazë për kryengritjen e Kosovës e të Malësisë (Aurela Elmasllari, "Femra shqiptare të

spikatura", 2012). Trimëresha Shotë Galica, luftoi në Lëvizjen Kaçake për 12 vjet rresht, duke marrë pjesë në më shumë se 70 aksione të armatosura kundër pushtuesit serb dhe austrohungarez. Prandaj, me të drejtë Shote Galica është sinonim i trimërisë dhe i luftës për liri të gruas Shqiptare.

2. Shotë Galica, luftëtare dhe grua

Në pyetjen kërkimore: Pse Shotë Galica, zgjodhi rrugën më të vështirë të bërjes së lirisë, luftën? Dilema zhvillohet te liria e individit, si pjesë e lirisë kolektive, e cila më tutje shtjellon lirinë si ideal i popujve historik.

Nënat, motrat, dhe gratë shqiptare, të cilat e zgjodhën rrugën më të vështirë për të luftuar për lirinë, padyshim se kishin dy arsye madhore. E para, si pjesëtare të shoqërisë së shtypur nga armiku dhe, e dyta, si qenie njerëzore të dorës së dytë, edhe sipas kanunit. Të shtypura e të nënçmuara përbrenda vet shoqërisë, duke qenë të pabarabarta në familje të gjakut dhe të burrit, pavarësisht kthjelltësisë së mendjes dhetributeve që mund të kenë pasur, ato, prapë se prapë ishin pas vëllait, pas burrit. Kjo katërçipërisht lidhet me zakonet e ashpra dhe mentalitetin se burrat e kanë vendin aty ku merren vendimet, se lufta është për burra dhe prona është e burrave. Shotë Galica, edhe në jetë, edhe në luftë, disa herë i kishte thyer këto vendime duke vendosur vetë për veprimet, edhe me peshë historike. Shotë Galica, u bëri ballë stuhive e rrebesheve, duke u përballur jo vetëm me luftën në betejat më të rënda e të rezikshme, por edhe duke marrë pjesë në odën e burrave, aty ku merreshin shumë vendime e ku përgatitej plani për luftën. Në odën e burrave e kishte mësuar i ati ta merrte qëkur ishte e vogël dhe ajo e njëjta mirë peshën e odave, siç edhe epërsinë e burrave ndaj grave, të cilat në oda vetëm shërbenin dhe nuk e kishin të drejtën e fjalës. Prandaj, ajo me këto veprime, për disa ishte grua pa fre, e përdalë, e çka nuk ishte. Shotë Galica, krahas luftës frontale, po



luftonte edhe për lirinë e nënave e të grave shqiptare, të fëmijëve që pushtuesi po u ndalte rritjen. Në verën e vitit 1921 Shotë Galica vendosi ta dërgojë në vend betimin e dhënë pranë varreve të të pushkatuarve në Dubovc. Ajo e vret naçallnikun serb me dorë të vet, ia numëron shtatë here plumbat në lule të ballit. Me pas Shota do t'i thotë Azemit: "E vrava Azem! E vrava në emër të nënave që i ka lënë pa djem, në emër të nuseve që i ka lënë pa burra, në emër të motrave që i ka lënë pa vëllezër, në emër të lirisë së Kosovës!" (Mehmet Bislimi, "Shotë Galica-Qerime Halili 1895-1927").

3. Shotë Galica dhe shteti shqiptar

Organet e shtetit shqiptar të Mbretit Zogu i Parë e vendosin së pari në fshatin Shullaz të Milotit, pastaj në Derven të Fushë Krujës. Kjo mënyrë e kujdesit dhe e vendosjes së Shotë Galicës dhe jetimëve të bashkëlufëtarëve të saj, do të thoshte, nëse i besohet filozofisë së popullit, me luftën tuaj, me sakrificën tuaj, nuk e meritoni as në këto fshatra të lëna të vendoseni, sepse na kenë prishur miqësinë me fqinjët tanë, me serbët.

Shotë Galica ishte në një gjendje të rëndë, edhe shëndetësore, pas plagëve që kishte marrë në luftimet në betejën e Llaushës, në vitin 1926. Ku t'i shëronte plagët, si të kujdesej për jetimët që kishte me vete, mbi të gjitha, i kishte amanet të bashkëlufëtarëve të saj, të rënë. Por, Mbretit Zog, i mjaftonte ajo pjesë që ia kishin lënë të tjerët, sepse që të bëhej mbret i shqiptarëve, fronin dhuratë e kishte po nga këta fqinjë që ia kishin pushtuar pjesët më gjallnore të vendit të tij.

Një zot e di nga ishte gjetur një mjek, që ishte kujdesur për shëndetin e saj, sa edhe ia kishte prerë gishtat e dorës, sepse i ishin ngrirë nga të ftohtit gjatë luftimeve. Mirëpo, as në të dhënat për jetën e Shotë Galicës, as në ndonjë dokument zyrtar që njihet deri tashti në historiografinë tonë, nuk flitet asgjë për jetimët që ajo i kishte marrë me vete. (Ajet Haxhiu, "Azem dhe Shote Galica", 1982). Nuk flitet as atëherë kur Shotë Galica kishte vdekur më 1927. Askush nuk e di, ku kanë shkuar, ku kanë krijuar familje, a janë gjallë dhe kush janë ata.

Në fund të fundit, një pyetje e përhershme që na rri në kokë, jo vetëm mua, por edhe lexuesve të tjerë shqiptarë të kësaj pjese të historisë së shtetit shqiptar, është se çka e shtynte shtetin shqiptar të mbante qëndrim të këtuillë ndaj luftëtares së lirisë, Shotë Galicës? Nëse përcillen me vëmendje ngjarjet historike të atyre viteve, pra që nga viti 1924 kur përmbyset qeveria e Fan Nolit dhe, kur rikthehet në fronin e shtetit shqiptar Ahmet Zogu, atëherë mund të shihet qartë se prania e duarve të huaja në jetën e brendshme të shtetit shqiptar

ishte shumë e madhe dhe ishte tragjike.

Më 23 prill të vitit 1924 vritet Avni Rrustemi, ai që kishte vrarë tradhtinë kombëtar në Paris, kur e vrau Esad Pashë Toptanin, i cili ia kishte dhënë, përveç të tjerave, edhe Shkodrën Malit të Zi.

Më 2 mars të vitit 1925 vritet në Bari të Italisë, Luigj Gurakuqi, autori i tekstit të Pavarësisë së Shqipërisë, krahu i djathtë i Ismail Qemalit. Njeriu që tërë jetën ia kishte kushtuar lirisë dhe arsimimit të popullit shqiptar.

Po atë vit, më 29 mars, në një shpellë në Grykën e Dragobisë i rrethuar një zot e di se nga forca të cilit sistem, apo të cilit shtet, apo të paguar nga kush, vritet Bajram Curri, për të cilin, nëse asgjë tjetër nuk do të ishte ruajtur në kujtesën tonë, vetëm poezia e Fan Nolit "Te Shpellë e Dragobisë (Elegji për Bajram Currin)", mjafton që ai të jetë i pavdekshëm.

Më 10 korrik të vitit 1927, në moshën 32-vjeçare, në gjendje të mjerueshme, i mbyll sytë njëherë e përgjithmonë Heroina e Popullit, Shotë Galica. Përkundër përpjekjeve të mëdha, me organizim të fshehur, apo duke gjetur njerëz me pagesë, që varrimi i saj të bëhej në heshitje, kjo nuk kishte ndodhur. Varrimi i saj në Fushë-Krujë, nuk u bë në heshitje, siç dëshironte qeveria e Ahmet Zogut, por erdhën shumë njerëz nga rrethet e ndryshme, gjë që dëshmon se ky popull e do lirinë, se ky popull di të vlerësojë sakrificën dhe luftën për liri e për bashkim kombëtar.

Më 14 gusht të vitit 1933, në Selanik vritet intelektual patrioti, Hasan Prishtina, figura më madhore e luftërave shqiptare për liri dhe bashkim kombëtar.

Sot, kur flasim për një figurë të ndritur të historisë sonë më të re, për një heroinë që kishte nëpërkëmbur edhe moralin e ditës, edhe ligjin e thashethemeve të kohës, edhe mentalitetin e trimave, se lufta është vetëm për burra, siç është figura e Shotë Galicës, deshëm apo nuk deshëm, na sillet nëpër kokë pyetja: kush i kishte vrarë këta atdhetarë të luftës për liri kombëtare? Kush ishin dorasësit, kush porositisit dhe kush paguesit e shumave të parave, të cilat përmenden në nivelet e qeverisë së Mbretit Zog, edhe kur vritet Bajram Curri. (Eugen Shehu, "Azem Galica, shkëmb i Drenicës", "Gazeta Shqiptari.eu", 2016). Pra, kush ishin ata që e kishin lënë në atë gjendje të mjerueshme luftëtares e lirisë, Shotë Galicën dhe jetimët e bashkëlufëtarëve të saj?

Pa marrë parasysh dilemat që mund të hapin dokumentet arkivore, të ditur deri sot, apo që do të zbulohen në të ardhmen, një fakt është shumë i qartë dhe shihet si ditën me diell, se ata i kanë vrarë organet e shtetit shqiptar, ku pushtetin e kishte Mbreti Zog. Do të thotë, prandaj, Shotë Galicën, në atë gjendje të mjerueshme, e kishin lënë organet e shtetit shqiptar, të

qeverisë së Mbretit Zogu i Parë, sa duhej ta shiste edhe shenjën e fundit të jetës së saj, me Azem Galicën, kalin e tij që e mbante si kujtim të luftërave dhe jetës me të, vetëm për të ushqyer jetimët që ia kishin lënë amanet bashkëlufëtarët e saj e të Azemit.

Përfundim

Historia e Shotë Galicës dhe e femrave të tjera shqiptare në historinë e këtij populli, është histori e femrave të jashtëzakonshme, sepse ato kanë pasur guximin njerëzor dhe luftarak të përballen me kurthet e jetës deri në sakrificë supreme. Shotë Galica, nuk është vetëm heroina e betejave të çetave kaçake në Kosovë, ajo është heroina e përbaljes me traditën e me zakonin, me kanunin e me thashethemet, të cilat jo vetëm për kohën kur ka vepruar ajo, por edhe sot e kësaj dite duan guxim dhe shumë kurajo për t'u përballur me to.

Francezët, më 1920, kur kishin parë një fotografi të mrekullueshme të Shotë Galicës, të punuar me mjeshtri nga Kel Marubi, e kishin quajtur "Zhan d'Arkë shqiptare". Sot, në këtë sesion shkencor, ndoshta ky krahasim nuk ka rëndësi të madhe, edhe për faktin se nuk e di a jemi mirë me ndërgjegjen tonë kombëtare dhe intelektuale, qoftë edhe për ta përmësuar pyetjen: a kemi bërë sa e si duhet për figurën e Heroinës së Popullit Shotë Galica. Në Kosovë, u deshën 18 vjet pas luftës së UÇK-së, që të bëhet një hap siç duhet për veprën madhore të Shotë Galicës. Më 10 nëntor 2017, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në 90-vjetorin e vdekjes së saj, ka themeluar urdhrin "Shotë Galica", me të cilën do të nderohen figura të shquara të kombit për sakrificë dhe liri.

Çdo gjë tjetër, qoftë edhe si arsytim i dokumenteve që mund të zbulohen, ose që janë zbuluar deri tashti, vetëm sa rrit edhe më shumë iluzionet tona, se askush nuk paska qenë tradhtar i vendit, askush nuk paska shitur asgjë të huajt, askush nuk paska vrarë për ta mbajtur pushtetin, si dhe askush nuk paska zbatuar kërkesat e atyre që u kishin ndihmuar të vinin në pushtet.

Dy shtetet shqiptare, nuk ka njohuri të kenë bërë asnjë përpjekje serioze, as nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim konkret që eshtrat e Shotë Galicës të kthehen pranë varrit të Azem Galicës, ku e kanë vendin.

Fare në fund, ftoj organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, si dhe organizimet e tjera që lidhen me veprimtarinë atdhetare të shqiptarëve, që të bashkohen dhe njëzëri të kërkojnë ndërtimin e një Memoriali, ku do të ishte edhe shtatorja e Shotë Galicës, ku shpirti i saj do të gjejë prehjen, në Kosovë, në vendin ku luftoi dhe pranë Azem Galicës. Ky memorial pastaj të shndërrohet në një nga atraksionet historike turistike të Kosovës.

Ericu dhe Rebecca po ndahen pas 14 vjetësh martesë



Eric Dane dhe gruaja e tij Rebecca Gayheart po divorcohen pas 14 vjetësh martesë. Gayheart ishte ajo që paraqiti dokumentet javën e kaluar në Los Angeles duke përmendur ndryshime të papajtueshme. Dokumentet kanë treguar se Gayheart po kërkon strehim


të përbashkët juridik dhe fizik për të dyja vajzat e tyre, Billie shtatëvjeçare dhe Georgia gjashtëvjeçare, si dhe mbështetje bashkëshortore. Eric dhe Rebecca kanë qenë të martuar për 14 vjet, pasi u fejuan në vitin 2004. Asnjëri prej tyre nuk ka komentuar publikisht divorcin.

Paditen Kendrick Lamar dhe SZA



Kendrick Lamar dhe SZA kanë përdorur punën artistike të një artisteje për ta promovuar projektin "Black Panther". Kështu thuhet sipas një padie të re. Lina Iris Viktor pretendon se punët e saj

artistike "Constellations I", "Constellations II" dhe "Constellations III" janë përdorur për videon zyrtare të këngës "All The Stars", edhe pse kjo kishte refuzuar të japë leje.



Rihanna mbush 30 vjet, Chris Browni e uron publikisht

Diva e muzikës, Rihanna, ka festuar 30-vjetorin e lindjes. Të shumta kanë qenë urimet për këngëtare nga ana e familjarëve dhe miqve të saj në këtë ditë të veçantë. Një ndër ata që e kanë uruar Rihannën ka qenë

edhe Chris Brown, i cili, pavarësisht prej gjithçkaje, e ka uruar atë publikisht. Reperi ka postuar në rrjetin social "Instagram" një fotografi të Rihannës kur ishte fëmijë, krahas së cilës shkruan: "Gëzuar ditëlindjen".

Colin Quinn shpëtoi nga sulmi në zemër



Colin Quinn, pësoi një sulm në zemër më 14 shkurt, por tani është më mirë. "Zemra ime pësoi sulm në ditën e Shën Valentinit. Aktualisht jam më mirë

edhe pse rashë si i vdekur. Ky sulm në zemër me të vërtetë më bëri të mendoj për jetën", ka shkruar aktori 58-vjeçar në llogarinë e tij në "Twitter".

Afrikë, diamante të reja do të nxirren nga fundi i oqeanit

Në rreth pesëmbëdhjetë vjet, rezervat e diamantit në Namibi do të përfundojnë dhe një gjigant i minierave po planifikon të lëvizë kërkimet e tyre në fund të oqeanit. Disa studime parashikojnë se në 2019 kërkesa për diamante do të tejkalojë ofertën dhe se çmimet pritet të rriten me rreth tre herë krahasuar me çmimet aktuale. Ambientalistët protestojnë për shkatërrimin e ekosistemit detar.


Rënia ekstraktive – Sipas të dhënave të raportuara nga La Stampa, vitet e fundit, nxjerrja e diamantit në botë ka rënë për vite me radhë dhe është rreth 144 milion karat. Numrat shumë larg rekordit prej 177 milionë karatësh të arritur në vitin 2006. Namibia është veçanërisht e prekur nga kjo rënie dhe mund të jetë në fund të saj në pesëm-

bëdhjetë vjet.

Kolos – Kompania e Afrikës së Jugut De Beers, një degë e gjigandit me bazë në Londër 'Anglo-Amerikan', po punon për krahu me qeverinë në Namibi, një vend në të cilin ai mban disa koncesione minerare. Të dhënat mbi tezaurimin e mundshëm, e shtynë drejtorin komercial të Namdeb, të zotëruar përgjysmë nga De Beers dhe shteti, të pohojë se "diamantet detare janë e ardhmja jonë".

Parashikimet – Sipas Namdeb në të ardhmen 95% të diamanteve do të nxirren nga fundi i oqeanit dhe, sipas Departamentit të Shkencave Biologjike në Cape Toën, për shkak të cilësisë më të lartë çmimi pritet të rritet nga 187 në 528 \$ për karat .

Një sektor në zgjerim – Vitin e kaluar, kompanitë minerare nënujore kanë arritur të ardhura



mbi 600 milionë dollarë dhe sipas firmës konsulente Bain & Company dhe në 2019-ën, kërkesa për diamante do të

tejkalojë ofertën.

Kritikat mjedisore – Shoqatat ambientaliste janë gati për "luftë" për shkak të dëmeve që

shpimet do t'i shkaktonin faunës dhe florës nënujore, ndërsa Be-Beers theksojnë rritjen e punësimit. (*gazeta-Shqip.com*)

Dashuria e spiunit të famshëm Kim Filbi

Kim Filbi nuk ishte vetëm një ndër agentët më të rëndësishëm të kohës kur jetoi, por edhe një burrë i pashëm. Kaq vite më vonë, vijojnë të tregohen copëzat e historive të dashurisë që ai la pas në vendet ku ishte me mision tillë është dhe historia me Litzit (Litzit Friedman), një vajzë hebreje me të cilën do të dashurohej.

Ata u njohën bashkë në Austri dhe ndikimi i saj anti-Hitler ka qenë jo i paktë te agjenti i ri, shpirti i të cilit ishte përmblytur

nga idetë komuniste. Kim u strehua në familjen e vajzës e cila kishte treguar gatishmëri për të mbajtur simpatizantët e luftës



kundër fashizmit. Ishte Litzit e cila do tia hapte derën duke iu përgjigjur thirrjes së tij atë mbas-dite. Ishte si një dashuri me shikim të parë, dhe Kim nuk do ta harronte asnjëherë atë shkëndijë.

"Ajo ishte një person i sinqertë dhe e drejtpërdrejtë, duke më pyetur se sa para kisha". Ai do ti përgjigjej se kishte aq para sa mund të kalonte vitin. Ai do të pikaste menjëherë tek vajza vendosmërinë, e cila do të bënte të dashurohej me të. Ishte ajo që do të hapte një pjesë tjetër të rëndësishme në jetën e tij, pothuajse pa formë. Gruaja e panjohur hebreje do të bëhej lidhja jetike midis burrave idealist të Kembrixhit më vonë kur do të zhvendosej në Londër dhe botës së errët të spiunazhit sovjetik. Pavarësisht historive që ai ndër-

toi në vënde të tjera ku ishte me mision, Litzit mbeti gruaja më tërheqëse në historitë që tregohen për të. Historia e Litzit Friedman ka qenë shpesh e humbur apo e shtrembëruar në historitë e spiunëve të

Kembrixhit, të cilët zakonisht konsiderohen si një elitë e pastër mashkullore.

Të gjithë spiunët ishin burra, dy prej tyre ishin homoseksualë, dhe nëse imagjioni Kim Philby, Anthony Blunt, Donald Maclean dhe Guy Burgess duke argumentuar me njëri-tjetrin në dhoma të mbushura me tym në Kembrixh, duke u miqësuar me diplomatë naivë ose duke u ulur me rusët në stolat e parkut, nuk ka gjasa të imagjinosh ndonjë grua në krahu të tyre.

Për gjashtë vjet rresht çifti i ri forcën, kurajon, energjitë i vuri në shërbim të luftës kundër fashizmit, kësaj murtaje që s'po përmbahej as tej Gjermanisë. Kur Litzit ishte në listat e atyre që do të arrestoheshin, ajo iku në Angli, ku mori edhe nënshpëtimin anglezë e që edhe në vendin e ri, hebreja e re dhe e shkathët u vu në kontakt me partinë komuniste angleze duke e vënë përfundimisht të shoqin në shërbim të komunizmit sovjetik.

(*gazeta-Shqip.com*)



KUR OFICERËT CARISTË SHKELNIN PËR HERË TË PARË SHQIPËRINË NË 1913-n

Nga Armand PLAKA

Prezencën e tyre në Shqipëri shumëkush e lidh a priori me vitet '50 të shekullit të shkuar, e disa me fundin e Luftës së Dytë Botërore, ndërsa në shtabin e partizanëve shqiptarë duhej të ishte instaluar edhe një oficer ndërlidhës sovjetik si i dërguar special i Moskës në kuadër të Aleancës Antifashiste.


Në një perceptim më të gjerë, prezenca e tyre më e hershme lidhet me rolin e bjellogardistëve (kundërshtarët e bolshevikëve në Rusinë postcariste) në shërbim të ish-Mbretit Zog në vitin 1924.

Ndërkaq, historiografia zyrtare e njeh prezencën e tyre qysh në maj

1913, ndërsa ata erdhën si pjesë e forcave ndërkombëtare të dislokuara në Shkodër. Si anëtarë të Komisionit Ndërkombëtar të Kufijve, KNK, oficerët caristë, do të shkelnin kështu për herë të parë në tokën shqiptare.

Siluetat e tyre shihen qartë në njërin nga fotot që shoqëron këtë tekst, në ditët e para të instalimit të detashmenteve të huaja në Shkodër, ku ndryshe nga austro-hungarezët, anglezët, italianët dhe gjermanët, ata nuk do të kishin të drejtë të "performonin" me parada ushtarake përballë vendasve kuriozë e në dukje edhe entuziastë, të lodhur tashmë aq shumë nga vuajtjet që u sollën malazetë me topat e armët e tyre në përpjekje për të përmbushur

© Fotoarkiva-Armand PLAKA



ëndrrën e tyre shekullore. Ata do të njaftoheshin kështu vetëm me prezencën fizike të një grushti oficerësh madhorë, stafi civil e diplomatësh.

Pa e ditur, ata do ta ndjenin ndoshta për herë të fundit puhizën e lehtë të brigjeve të Adriatikut, pasi vetëm një vit më vonë do të shpërthente "Lufta e Madhe", e cila do të rezultonte me shumë pasoja për fatin e Rusisë dhe vetë njerëzimit.

Ndërsa Lufta po shënonte një katastrofë për ushtrinë cariste, Revolucioni Bolshevik i tetorit 1917, do të bënte që shumë syresh të braktisnin vendin, ose të gjenin vdekjen në luftë të hapur me komunistët.

Një tentativë e qeverisë së Nolit

në vjeshtën e 1924, do të ngjallte sërish shpresën e Moskës zyrtare për të vënë këmbë në Shqipëri, por ajo do të përfundonte me ardhjen e kundërshtarëve të tyre politikë si triumfatorë në fundvitin 1924 e fillimvitin 1925, duke i dhënë një dorë të konsiderueshme përpjekjeve të rivalit më intim të Nolit, për t'u rikthyer në pushtet në bashkëpunim të ngushtë me jugosllavët.

Do të duheshin edhe disa dekada që rusët të shkelnin sërish në Shqipëri, tashmë me një rol, pushtet e prezencë shumë më domethënëse, e cila do të kulmonte me vizitën e ish-shefit të atëhershëm të Kremlinit, Nikita Sergejeviç Hrushov në Tiranë, në vitin 1959.

Ky do të ishte paradoksisht edhe kulmi i marrëdhënieve shqiptaroruse (dmth. sovjetike), pasi ajo që pasoi, ishte një degradim shumë i shpejtë e radikal i marrëdhënieve të tyre ndërshtetërore (përveçse partiake).

Pas viteve nëntëdhjetë, marrëdhëniet mes dy vendeve njohën një ringritje, megjithëse dinamika e tyre ka pësuar shpesh ulje-ngritje.

Nën dritën e zhvillimeve të dy dekadave të fundit, e sidomos të viteve të fundit, hija e Moskës në Shqipëri është bërë sërish temë diskutimi, e artikulimi rreth politikave të saj kundrejt Shqipërisë e shqiptarëve, njeh shpesh edhe tone të ashpra.

(gazeta-Shqip.com)





Autor: GAZMEND MORINA	SHARRRËZ (shq.)	PJESA E BRENDSHME E TEMPULLIT GREK KU MU- ND TË HYJË VETËM PRIFTI	ZULMË	KOHË BRENDA SË CILËS DUHET TË KRYHET NJË VEPRIM	AKTORJA E NJOHUR SPELLING	OLIVER NEUVILLE	NGADHËNJIM NË NJË BETEJË	ZANORE	QYTET BREGDETAR NË ITALI	GRIMCOVA (bised.)	SHKRONJA TË NJËJTA
FRIKA PATOLOGJIKE NGA VDEKJA											
TËRËSIA E GJALLESAVE NË TOKA								BIMË MËMË (shq.) REGJISORJA ... ELEZI (shq.)			
PRONË E VOGËL E SPAHINJVE FEUDAL OTOMAN							TINARI MARC ANTHONY				KËNGËTARJA HOXHA
ARTIOLA TOSKA			SHTET NË AZI LINDOR VRAPIMI MË I GJATË NË ATLETIKE							ZANORE ÇMENDJE (sh.shq.)	
LIGJ, KANUN (vjet.)					SHKRIMTARJA KAMBERI	BISHË MALI (pashq.) I PËSHPËRITA FJALË MAGJIKE			DY BASHKË- TINGËLLORE POEZI LIRIKE PËRVAJSHME E PLOT DHEMBJE BIM		
BASKETBOLL- ISTI TURK OMER (shq.)							KUNDËRSH- TARI I BOLSHEVIZ- MIT RUS ARCITECTURE RESEARCH OFFICE				
ALARM I AUTOMJETIT BATARE							DËSHMORI KODRA (UÇK) FJALË E RËNDË (krah.)				

EPOKA ERE	AKTORJA AMERIKANE NË FOTO	MBARIMI I BOTËS (pashq.)	SHTET I MADH AZIATIK	ORGANIZATË SEPARATISTE NË SPANJË	"RIZONI" FORMË E TË HYRAVE SHTETËRORE (shq.)	LLOJ PAPAGALLI EPOKË (shq.)				PJATA OKSIGJEN, NATRIUM			
PJESË E SIPËRME KOSTUMIT, ME MËNGË E ME JAKË TË KTHYER	○						DEGË E GJUHËSISË QË STUDIOJ PREJARDHJEN E FJALËVE TË NJË GJUHE						NGADALË, JO SHPEJT (turq.)
MBISHKRIM NË NJË GUR VARRI	○						KLUB FUTBOLLI ITALIAN			SHPIRT (Lat.) REPER I SHQUAR AMERIKAN			
LLOJ VEPRE MUZIKORE	○						MALLKIMI DHE PËRJASHTIMI NGA KISHA ALI PODRIMJA					EDI VANTE QË KA ERË TË KËNDSHME	
U ARRATISA	○			ILLINOIS LIBRARY ASSOCIATION NJËRË NGA SIPËRFAQET KUFIZUESE TË NJË SENDI			PËRKULJE NË NJËRËN ANË (sh.pashq.) GRIMCAT MOLEKULARE			PËREMËR VETOR STUHI E FORTË ME ERË DHE SHI			
KALJARI, ATLANTA	○		ALYSSA MILANO ANËTARËSIM NË NJË ORGANIZATË			MINUS (Mat.) FUTBOLLISTI KALOU (CHELSEA)		E VËNË NË SITË PRINCIPATË ARABE				BASHKËT. BIXHOZ	
KËNGËTARJA E FAMSHME KANADEZE MORISSETTE	○						TEPELENA, ELBASANI	ALEN NURI I SHASTISUR		ZHANËR I MUZIKËS BASHKËT.			RIFAT AVDIU
KËNGËTARJA NDOCI VARG MALESH TË LARTA DHE TË ASHPRA	○				ZANORE E GDHEND		NJËSIA E REZISTENCËS ELEKTRIKE IVAN KLANIÇ	PASANIKE "INDIANA"					
➔	○			MËNJANIM NGA GARA						SHKRONJË GREKE KUSARI			
BRITISH SOCIETY RHEUMATOL.	○			KLUB FUTBOLLI NË BELGJIKË ENË E MADHË TENEOEJE PËR TË ZIER UJË						LLOJ SHPENDI ME QAFË TË GJATË "MAKORA"			PJESË E ILIRISË
ZANORE	○	I POSEDOJ TOKË E BUKËS (sh.shq.)					KAMION I VOGËL KËNGËTARJA VALENTINA			EMËR YNI FEMRE EURO DEPUTETJA DORIS ...			
EPOKA ERE	FILLESTAR FLUTURAKE JASHTËTOK- ËSORE						VECORI THELBËSORE E NJË DUKURIE ISH ATLETI MONTGOMERI				BASHKËT. METAL I HOLLUAR		BASHKËT. PA NDONJË DOBI
"URUGUAI"			HAPËSIRË E CAKTUAR TERRITORIALE (sh.shq.) NJË NGJYRË					FORCË, FUQI NAIM ISMAJLI				KLINT ISTVUD "TETOVA"	
LLOJ SHPENDI FUTBOLLISTI VAN PERSIE						MIU I VOGËL (pashq.) BASHKËT.				MUAJ I VITIT BASHKËT.			
➔					FUTBOLLISTI FRANCEZ NASRI (MANCHESTER CITY)			POPULLI (krah.)					

ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: TANATOFORJA, EDAFONI, AMJA, TIMAR, TIRA, AT, TIMORI, E, NOM, ARI, TL, ONANI, ESERI, SIRENA, ILAZ, I, ARARA, ENA, XHAKETA, ETIMOLOGJI, EPITAF, ROMA, ANIMA, SONATA, ANATEMA, EV, IKA, ILA, ANIME, ATA, KA, AM, PA, E SITUR, SH, ALANIS, TE, AN, ROK, AIDA, A, OMI, E KAMUR, ALPE, ELIMINIM, GAMJA, BSR, LOKEREN, PATJA, A, I, KAM, TAM, MINIRE, AMATOR, TIFAR, K, P, UR, ZONAT, TAKAT, KI, FAZAN, MINUK, TETOR, ROBIN, SAMIR, MILLETI.

E rrallë

Pema 300-vjeçare në Louisiana

Në rajonin juglindor të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) gjendet Luiziana, shtet ky i njohur për diçka të jashtëzakonshme. Lisat të cilët gjenden në një zonë ambienti të këtij shteti datojnë për pothuajse 300 vjet dhe ato degë tashmë kanë krijuar hijet e tyre mahnitëse që po mrekullojnë botën.



FOTO E DITES



Dy persona në Sumatra në Indonezi shihen duke pastruar rrugën nga hiri që erdhi si pasojë e vullkanit të Malit Sinabung. /AP/

E jashtëzakonshme

Zotëron 32 gjuhë, i ka mësuar vetëm duke lexuar

Të gjithë ata që flasin disa gjuhë të huaja kanë një nivel të lartë inteligjence. Shumica e njerëzve mësojnë deri në tri gjuhë të huaja gjatë jetës së tyre, por Janis Ikonomu është krejt ndryshe. Ai di të flasë 32 gjuhë të huaja dhe të gjitha i ka mësuar vetëm duke lexuar, në mënyrë autodidakte. Janis ka lindur në Greqi dhe që në moshën 20-vjeçare ai dinte 15 gjuhë.



BARSOLETA E DITËS



Një shitëse i ankohet shoqes:

- Nuk jam më e bukur siç isha dikur.
- E si e di?
- Blerësit kanë filluar t'i numërojnë paratë kur ua kthej kusurin.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00

“FERDINAND”

3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 46 min

Rolet: John Cena, Kate McKinnon, Gina Rodriguez, Daveed Diggs, Gabriel Iglesias, Bobby Cannavale, David Tennant, Anthony Anderson, etj.

Regjia: Carlos Saldanha



Në ora 18:00 dhe 20:00 (R) “FIFTY SHADES FREED”

Dramë/Romansë/Triller; 1 orë 41 min

Rolet: Dakota Johnson, Jamie Dornan, Eric Johnson, Rita Ora, Luke Grimes, Victor Rasuk, Jennifer Ehle, Eloise Mumford, Max Martini, Callum Keith Rennie, Bruce Altman, Arielle Kebbel, Robinne Lee, Brant Daugherty, Marcia Gay Harden, etj.

Regjia: James Foley

Në ora 22:00 (PG-13)

“THE COMMUTER”

Krim/Dramë/Mister; 1 orë 44 min

Rolet: Liam Neeson, Vera Farmiga, Patrick Wilson, Jonathan Banks, Sam Neill, etj.

Regjia: Jaume Collet-Serra



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

Gjithçka që nuk ka ecur sipas planeve tuaja sot mund të rivlerësohet nëse paraqitet një situatë e re.



DEMI

Me kalimin e Hënës në shenjë ju do të bëheni shumë të dashur me njerëzit që ju rrethojnë dhe partnerin. Nuk do të ndaleni në surpriza sot.



BINJAKËT

Pozitiviteti dhe energjitë e mira sot do të superojnë ato momente dyshimi që do t'ju kaplojnë gjatë ditës. E rëndësishme është të ndiheni mirë.



GAFORRJA

Një ekuilibër perfekt midis dashurisë dhe karrierës sot do të bëjë që ju të jeni epiqendra e shumë situatave interesante.



LUANI

Sot duhet t'ia dilni mban vetë një problemi që mund të lindë në punë. Edhe pse jeni dyshues në aftësitë tuaja, do t'i keni përfundimet e shkëlqyera.



VIJGJËRËSHA

Ndiheni disi të zhgënjyer nga partneri sot sepse nuk ka të njëjtin përkushtim si ju në lidhje. Mbase ngaqë ndryshojnë karakteret tuaja.



PESHORJA

Sot dita paraqitet shumë e këndshme, saqë në momentet e caktuara do t'ju duket sikur keni ikur përsëri me pushime.



AKREPI

Sot do të mbizotërojnë ndjenja e xhelozisë në ditën tuaj. Edhe për situata shumë të pafajshme do ta bëni fajtor partnerin.



SHIGJETARI

Keni nisur ditën me shumë vull dhe po kështu do ta përfundoni. Keni energji pa fund dhe iniciativat e reja që keni ndërmarrë po ju pëlqejnë.



BRICJAPI

Sot duhet të jeni më konkret në planet dhe punët tuaja. Shumë ide dhe mendime nuk po arrihi t'i konkretizoni në praktikë.



UJORI

Çdo gjë shkon mirë me partnerin dhe miqtë tuaj, por nuk mund të thuhet e njëjta gjë për financa. Po ndjeni që keni nevojë për disa të ardhura mujore më tepër.



PESHQIT

Do të merrni një mesazh mjaft të qartë nga personi për të cilin po mendoni kohët e fundit. Pritet një dashuri e re në horizont.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adri: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	LEIPZIG - NAPOLI	GG3+	PLZEN - PARTIZAN BELGRADE	1-1	VILLARREAL - LYON	1
-------------------	------------------	------	---------------------------	-----	-------------------	---

Korenica: Plagën e Kupës e shërojmë në kampionat

Meriton Korenica beson se gabimin me eliminim nga Kupa, Liria do ta përmirësojë në kampionat. "Tash jemi të fokusuar maksimalisht në kampionat. Lufta është ende e hapur për titull dhe diferenca e pikëve në mes të skuadrave të para është e vogël. Do të jetë një garë e gjatë dhe me shumë befasi. Kam besim të plotë në këtë grup të lojtarëve. Nëse e japim maksimumin në vazhdimësi, atëherë gjerat e mëdha do të ndodhin", ka thënë Meriton Korenica



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 21 SHKURT - Futbollisti i Lirisë së Prizrenit, Meriton Korenica, është i lumtur se skuadra e tij e ka nisur sezonin pranveror me fitore. Në fakt, Liria e mposhti Vllazninë e Pozharanit (2-1), kurse lojtari në fjalë beson se kjo skuadër do të përmirësohet sidomos në repartin defansiv. "E filluam sezonin pranveror me fitore në kampionat dhe kjo është shumë me rëndësi. Në sezonin vjeshtor kemi humbur shumë pikë në sekondat e fundit të ndeshjeve, kurse tash besoj se do të përmirësohemi në këtë pikë

dhe rezultatet do të janë më pozitive", ka thënë Korenica, i cili më pas ka folur edhe për eliminimin nga Kupa.

Ai e ka quajtur të dhembshëm faktin se skuadra nga Prizreni nuk do ta ndjekë Kupën deri në fund. "Është për keqardhje fakti se jemi eliminuar nga Kupa, por ajo ndeshje ishte e vështirë dhe nuk e kishim mundësinë të luanim futboll, sepse gjendja e fushës ishte e rënduar shumë nga shiu, bora dhe balta. Penallitë janë më shumë çështje fati dhe atë ditë fati ishte në anën e kundërshtarit. Ky eliminim na dhemb për faktin se kemi pasur objektiv daljen në Evropë", ka

deklaruar Korenica.

Lojtari i skuadrës që drejtohet nga Blendi Shkëmbi është optimist se në kampionat gjerat do të ecin pozitivisht për skuadrën e tij. "Tash jemi të fokusuar maksimalisht në kampionat. Lufta është ende e hapur për titull dhe diferenca e pikëve në mes të skuadrave të para është e vogël. Do të jetë një garë e gjatë dhe me shumë befasi. Kam besim të plotë në këtë grup të lojtarëve. Nëse e japim maksimumin në vazhdimësi, gjerat e mëdha do të ndodhin", ka deklaruar Korenica. Skuadra e Lirisë renditet në pozitën e katërt në renditjen tabelore me 31 pikë të grumbulluara.

Greenberg: Ndaj Polonisë mund të bëjmë gjera të mira

"Jemi të emocionuar. Ky është një shans i mirë për të luajtur në Poloni, pasi kemi dëgjuar se këtu atmosfera është shumë e mirë. Po ashtu, Polonia ka një skuadër shumë të fortë. Aktualisht është e 28-ta në renditjen botërore, por unë besoj se djemtë tanë do të bëjnë më të mirën", ka thënë Brad Greenbergu

PRISHTINË, 21 SHKURT - Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll ka hyrë në ditën e dytë të grumbullimit në Torun të Polonisë, ndërsa pas stërvitjes së tretë përgjdhësi i Kosovës, Brad Greenberg, ka thënë se është i emocionuar që do të përballlet me Poloninë, por ka shfaqur besim të plotë se basketbollistët e Kosovës do të kenë një paraqitje të mirë. "Deri më tani i kemi zhvilluar tri stërvitje dhe jam i kënaqur me punën që e kanë bërë basketbollistët. Është shumë mirë që i kemi që të gjithë këtu, posaçërisht që tani e kemi

në dispozicion edhe Shawn Jonesin dhe që është rikthyer Erjon Kastrati. Jemi të emocionuar. Ky është një shans i mirë për të luajtur në Poloni, pasi kemi dëgjuar se këtu atmosfera është shumë e mirë. Po ashtu, Polonia ka një skuadër shumë të fortë, aktualisht është e 28-ta në renditjen botërore, por unë besoj se djemtë tanë do të bëjnë më të mirën", ka thënë Greenbergu për faqen zyrtare të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK).

Më pas trajneri amerikan ka folur edhe për Dardan Berishën dhe Lis Shoshin, duke konfirmuar se



të dy këta basketbollistë janë në formë të mirë. "Dardani është në formë të mirë, Lisi po ashtu. Ata me ekipet e tyre në Çeki, përkatësisht Lituanë, janë në mes të edicioneve. Edhe Shawn është duke bërë mirë me klubin e tij Dinamo Sassari në Itali. Kjo përbërje e ekipit do të luajë për herë të parë së bashku. Shawn nuk ka luajtur

asnjëherë deri më tani me Erjonin dhe unë nuk e kam pasur rastin ta kem atë në dispozicion kurrë më parë. Ne kemi shumë punë të bërë, por shpresojmë të luajmë sa më mirë më 23 shkurt kundër Polonisë dhe më 26 ndaj Lituanisë", ka deklaruar ai. Përfaqësuesja e Kosovës të dielën ka zbarkuar në Torun të Polonisë,

ku do të qëndrojë deri më 22 shkurt dhe më pas do të zhvendoset për në Wloclawek, qytetin ku edhe do të zhvillohet ndeshja me polakët. Kosova do të ballafaqohet me Poloninë më 23 shkurt duke filluar nga ora 19:00 në Wloclawek, kurse më 26 shkurt në Klaipeda do të jetë mysafire e Lituanisë, takim ky që do të luhet me fillim nga ora 19:30. Të dyja këto ndeshje i takojnë Dritares së Dytë të Grupit C të kualifikimeve evropiane të Kupës së Botës "Kina 2019", ku Kosova është në grup me Lituaninë, Hungarinë dhe Poloninë. Duhet theksuar se në dy ndeshjet e Dritares së Parë të kualifikimeve evropiane për Kupën e Botës "Kina 2019", Kosova ka pësuar disfata, së pari në shtëpi në përballje me Lituaninë, më pas si mysafire në ballafaqim me Hungarinë.

Promovohet libri "Njeriu që bëri epokë"

PRISHTINË, 21 SHKURT - "Njeriu që bëri epokë" është libri që i kushtohet kryetarit të nderit në KF Feronikelit, Avdi Krasniqi. Promovimi i këtij libri është bërë të mërkurën në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, kurse

pjesëmarrës ishin personalitete të njohura, në mesin e të cilëve edhe kryetari i Partisë Liberale të Kosovës (PLK), Skënder Gashi dhe humoristi Rasim Thaçi-Cima. "Në mesin e njerëzimit, ku mësohet e zbatohet kodi i nderit, i moralit të

pastër, i miqësisë, i dashurisë, i respektit, sakrificës, i vetëmohimit, aty jo, jo s'ka njerëz të vegjël, o të mëdhenj, s'ka të pasur, o varfanjakë, s'ka uri, urrejtje, as mëri, s'ka njerëz të robëruar, as lypsarë, as të uritur, por ka dashuri, vëllazëri,

lumturi, paqe...", ka thënë autori i librit, Riza Greiçevci. Në promovimin e librit "Njeriu që bëri epokë" kanë folur edhe ish-trajneri i Feronikelit, Musa Selimi si dhe Fadil Hoxha, Beqir Aliu dhe Zet Avdyli.



Haradinaj përkrah maratonistët për "Shtegun e Shpresës"

PRISHTINË, 21 SHKURT - Në shënim të 20-vjetorit të nisjes së luftës për çlirim të Kosovës dhe me rastin e dhjetëvjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, kryeministri Ramush Haradinaj priti të mërkurën në takim anëtarët e Asociacionit Kosovar për Vrapim Malor

(Kosova Trail Running Association-KTRA). Përmes një komunikate për medie bëhet me dije se në këtë takim kryeministri u njoftua për nisimën e KTRA-së për organizimin e "Shtegut të Shpresës", i cili do fillojë në Prekaz, për të vazhduar në Glllogjan dhe me

përfundim në Koshare. "Shtegu prej 100 kilometrash do të jetë i ndarë në pesë segmente dhe do të zhvillohet nga datat 3 dhe 4 mars 2018", thuhet në komunikatë. Haradinaj ofroi përkrahjen e tij për këtë organizim, që do të mbahet në shenjë nderimi për

luftën e lavdishme të UÇK-së dhe 10-vjetorin e pavarësisë. Po ashtu, kryeministri tha se është vrapues i rregullt nëpër malet dhe bjeshkët e mrekullueshme që ka Kosova. Pas pritjes që ua bëri anëtarëve të Asociacionit Kosovar për Vrapim Malor, për ta mbështetur kauzën e tyre,



Haradinaj u bashkua në vrapimin parapërgatitor të maratonës së vrapimit, të organizuar në parkun e Gërmisë.

Atalanta - Dortmund, spektakli transferohet në Itali

BERGAMO, 21 SHKURT - Atalanta dhe Borussia Dortmund, pas një ndeshje spektakolare të zhvilluar në takimin e parë të luajtur në "Signal Iduna Park", e vlefshme për 1/16-at e Evropa Ligë, do të përballen sonte (e enjte) në Itali për ndeshjen e kthimit. "Verdhezinjtë" do të paraqiten në këtë sfidë me një gol avantazh pas fitores 3-2 të marrë në shtëpi. Atalanta mban vendin e tetë në renditjen e Serisë A, tri pikë larg zonës së Evropa Ligës dhe do të zbresë në fushë pas barazimit 1-1 të marrë në shtëpi kundër Fiorentinas të dielën e kaluar.



raundin pasardhës do të ishte fantastik".

Përballë zikaltërve do të jetë një Dortmund që duket se është kthyer në rrugën e duhur pas pushimit të dimrit, duke marrë katër fitore dhe tri barazime në shtatë ndeshjet e fundit të luajtura në të gjitha kompeticionet dhe duke u ngjitur në vendin e dytë të Bundesligas, raporton "Telesport".

Atalanta ka shënuar gol në të gjitha

LIGA E EVROPËS

17:00 Lokomotiv M.-Nice
19:00 Atletico Madrid-Koebenhavn
19:00 Dynamo Kyiv-AEK Athens
19:00 Lazio-FC FCSB
19:00 Leipzig-Napoli
19:00 Sporting CP-FC Astana
19:00 Viktoria Plzen-Partizan Beograd
19:00 Villarreal-Lyon
19:00 Zenit-Celtic
21:05 Milan-Ludogorets R.
21:05 Arsenal-Oestersunds
21:05 Atalanta-Borussia Dortmund
21:05 Athletic Bilbao-Spartak M.
21:05 Braga-Marseille
21:05 Salzburg-Real S.

shtatë ndeshjet që ka luajtur në këtë edicion të Evropa Ligës dhe mesatarja e golave të shënuar në ndeshjet e këtij sezoni është 3.29. Dortmundi nuk ka fituar asnjë nga gjashtë ndeshjet e fundit evropiane që ka luajtur në transfertë. "Verdhezinjtë" kanë regjistruar dy barazime dhe katër humbje.

'Pyeongchang 2018', jepen të tjera medalje olimprike

PYONCHANG, 21 SHKURT - Lojëratar Olimpik Dimërore të Pyeongchang kanë regjistruar fitues të tjerë medaljesh. Në garën e stafetës së përzier në Biatlon, triumfi ishte për skuadrën e Francës me 1 orë e 8 minuta e 34.3 sekonda.

Në vendin e dytë, duke fituar medaljen e argjendtë, u rendit Norvegjia, ndërsa medaljen e bronzit e fitoi Italia. Në Patinazhin artistik, vallëzimi i lirë për çifte, medalja e artë u shkoi kanadezëve Tessa Virtue dhe Scott Moir me 206.07 pikë të grumbulluara. Medaljen e argjendtë e fitoi çifti francez Papadakis/Cizeron, ndërsa në vendin e tretë u renditën



amerikanët Alex dhe Maia Shibutani. Kanadaja fitoi medalje të artë edhe në disiplinën Ski Halfpipe për femra nëpërmjet Cassie Sharpe me 95.8 pikë. Sharpe la pas francezen Marie Martino dhe amerikanen Brita Sigourney që fituan medaljen

e argjendtë dhe të bronzit.

Në stafetën 3000 m për femra në Patinazhin e Shpejtësisë në pistë të shkurtër, medalja e artë i shkoi Koresë së Jugut, në vendin e dytë u rendit Italia, ndërsa e treta u rendit Holanda. Për t'u theksuar është se pati penalizime për Kanadanë dhe Kinën me këtë të fundit që në fund të garës u rendit e para. Në tabelën e medaljeve vazhdon të kryesojë Norvegjia me 11 medalje ari, 11 argjendi dhe 8 bronz. Në vendin e dytë është Gjermania me 11 medalje të arta, 7 të argjendta dhe 5 të bronzta, ndërsa e treta është Kanadaja me 9 medalje ari, 5 argjendi dhe 6 bronz.

Vëllaznimi në zemrën e Canës

GAJKOVË, 21 SHKURT - Lorik Cana ka treguar gjithmonë që ruan lidhje të forta me vendin e tij. Përveç patriotizmit ndaj vendit të tij, ai është një mbështetës i madh edhe i ekipit të qytetit të tij, Vëllaznimit të Gjakovës. Babai i tij, Agim Cana, është bërë president i këtij ekipi, i cili ka qenë në vështirësi ekonomike vitet e fundit, por pritet që Agim Cana të bëjë të pamundurën për ta ndryshuar

situatën në ekipin e tij të zemrës. Edhe Loriku ka shprehur mbështetje ndaj Vëllaznimit. Ai ka pozuar në një foto me një fanellë të Vëllaznimit që mban mbiemrin e tij nga mbrapa dhe numrin 5, të cilin Cana e ka mbajtur te Kombëtarja. Së fundmi, sponsor i Vëllaznimit është bërë "Macron", firma e njohur e cila prodhon edhe fanellat e Kombëtares.



SHKURT

Më 6 mars kontrollimet mjekësore të gjyqtarëve të futsallit

Komisioni i Gjyqtarëve, në bashkërendim me Qendrën Kombëtare të Mjekësisë Sportive në Prishtinë, ka hartuar orarin e kontrollimeve mjekësore për gjyqtarët. Pra, më 6 mars në orën 12:00 të gjithë gjyqtarët e futsallit janë të obliguar të paraqiten në këtë qendër dhe t'i kryejnë kontrollimet mjekësore.

Barazimi, i pavlerë për Willian

Autori i golit të parë në ndeshjen Chelsea - Barcelona, Willian, ka shprehur mendimin se skuadra e tij e ka merituar fitoren. "Jam i lumtur për golin, por pak i pakënaqur me rezultatin. E meritua fitoren. Kishin posedimin, por ne ishim më të rrezikshëm me rastet për gol. Duhet të shkojmë atje dhe të luajmë lojë të njëjtë. Isha i pafat. Duhet të punoj dhe mezi pres ndeshjet e ardhshme", ka thënë Willian.

Chelsea dhe Bayerni në "luftë" për Pulisiqin

Chelsea dhe Bayern Muncheni janë në "luftë" për talentin e Borussia Dortmundit, Christian Pulisiq. "Blutë e Londrës" e kanë kthyer lojtarin amerikan një ndër objektivat kryesorë në afatin kalimtar të verës, duke e konsideruar zëvendësues të Eden Hazardit ose Willian, në rast se një prej të dyve vendos të largohet. Në "pole position" për shërbimet e Pulisiqit është klubi "bavarez" që përfaqësohet nga Franck Ribery dhe Arjen Robbenin. Vështirë se Dortmundi do të dëshirojë t'ua shesë yllin e tyre rivalëve të Bayernit, edhe pse në të shkuarën e ka pasur të pamundur t'u rezistojë ofertave për Robert Lewandowskin, Mario Gotzen apo Mats Hummelsin.

Milani kërkon Dzekon

Pjesë e organikës së Milanit është Andre Silva, i blerë për 38 milionë euro nga Porto, Kaliniq, por edhe ylli Cutrone, por sërish në shtëpinë e Milanit nuk janë të kënaqur me repartin ofensiv. "Tuttosport" ka shkruar se Milani është i interesuar për boshnjakun e Romës, Edin Dzeko. Sulmuesi shtatlartë ishte pranë Chelseas në merkaton e janarit, por marrëveshja nuk u arrit, ndërsa sipas "Tuttosport", largimi i tij nga Roma është thuajse i sigurt në merkaton e verës. Gazeta torineze shkruan se ai do të ishte sulmuesi i përkryer për skuadrën e drejtuar nga Gattuso.

Williamsi: Rrezikova jetën kur linda vajzën time

Dita më e bukur e jetës, ajo kur u bë nënë për herë të parë, mund të ishte edhe e fundit për tenisten amerikane Serena Williams. Pesë muaj pas lindjes së vajzës së saj, tenistja amerikane ka rrëfyer në një letër të gjatë të bërë publike sot, se ka rrezikuar të ndërronte jetë gjatë sjelljes në jetë të fëmijës. Një përvojë dramatike, për të cilën Serena ka rrëfyer disa detaje. "Desh ndërrova jetë në momentin që solla në jetë vajzën time Olympia. Ndaj, e konsideroj veten me fat. Pata një shtatzëni të lehtë, por ditët pas lindjes kanë qenë të trazura. Gjithçka nisi pas një ftohje në mushkëri", ka thënë Williamsi. Duke e njohur historinë time mjekësore, jetoj gjithnjë në frikë. Ndaj, kur ndjeva se po më mungonte ajri, nuk prita asnjë sekondë dhe e njoftova infermieren. Kjo situatë solli komplikime të tjera, ndaj e konsideroj veten me fat që mbijetova", thotë ish-numri një në botë. Serena rrëfhet se ka kryer edhe një operacion tjetër, ku u evidentua problemi në mushkëri dhe më pas një të dytë për ta sistemuar situatën. "Kur u ktheva në shtëpi, pranë vajzës time, i kam kaluar javët e para pas lindjes në krevat, pushim absolut. I kërkoj qeverisë, të çdo vendi, mjekëve në spitale private e shtetërore, që të marrin masa për ta shpëtuar jetën e njerëzve", ka deklaruar Williamsi.

Shijo Pranverën me...

Jaffa
Champion **PLUS**
A+C+E
Multifrutti

Taste of World Wide Brand!

2L

Jaffa
Champion

Produkte Bio natyrale **MATI**

Djath I Dhisë MATI 300g

Mati com 1 litër

Djath Mati MATI 400g

Djath Mati MATI 700g

Fabrika për prodhimin dhe përpunimin e qumështit të Dhisë dhe Lopës

Mati -com Sh.P.K. është ndërmarje prodhuese vendore e cila prodhon dhe përpunon qumësht të dhisë dhe lopës

Email: mati-com@outlook.com
tel: +386 49 288-340
Kijevë-Malishevë

MATI-COM

An EU funded project managed by the European Union Office in Kosovo

N.N.P.Mati Com SHPK



Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës



Drejtoria Për Arsimit dhe Edukimit

Nr. 11/17

Me: 21.02.2018

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 90/2010), Neni 5 pikësc. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Drejtoria për Arsim dhe Edukimit shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të punës

Viti shkollor 2017/2018

Nr.	Niveli, Shkolla	Pozita	Vendi i lirë/zëvendësim	Numri i pozitave	orë
1	SHFMU "Dëshmoret e fshatit" në Bubavec	Mesimdhënës i programit fillor	Zavendesim i lehonisë me kohë të caktuar	1	20
2	SHFMU "Ismail Qemali" në Bellanicë	Mesimdhënës i lëndës së gjuhës angleze	Zavendesim i lehonisë me kohë të caktuar	1	20

I. Aplikacionit i bashëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit
- Rezumeja personale (CV)
- Dokumenti personal (letërnjoftimi ose pasaporta)
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të notorizuar të noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj.
- Çertifikata që nuk jeni nën hetime
- Dëshmi të përvojës në institucionet arsimore (nëse ka)

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktura me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar.

Kriteret e kualifikimit, Për mesimdhënës klasor: Fakulteti i Edukimit -Programi Fillor, Fakulteti i Mësuesisë

Kriteret e kualifikimit, Për mesimdhënës të lëndës së gjuhës angleze: Fakulteti i edukimit -Programi i gjuhës dhe letërsisë angleze, Fakulteti i Filologjisë-dega e gjuhës dhe letërsisë angleze, ashtu siç planifikohet me UA të MASHT-it Nr. 05/2015 dhe UA 06/2015

Vetëm në mungesë të kandidatëve nga sqarimi i lartcekur, do të shqyrtohen dhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim më të përparë.

III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuar dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta dhe të verteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ata që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi)

SQARIM: Kandidatët mund të konkurojnë në shumë shkolla, por me dokumente të veçanta.

Përsonat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të jenë të notifikuar diplomat nga MASHT.

Për intervistë do të ftohën ata kandidat të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë dhe orari i intervistave publikohet në web-faqen e Komunës së Malishevës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më: **21.02.2018 deri më datën 07.03.2018**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkura) duhet të dorëzohet përmes protokollit, përkatësisht përmes zyrës së pritjes së palëve, në objektin e ri të Komunës së Malishevës.



KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOISNABEVANJE D.D.
PRISHTINA

D P A

Departamenti për punë administrative
Department for administrative works

Prishtinë me 20.02.2018 Nr. 328

Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë Rajonale të Ujësjetës „Prishtina“ sh.a.– Prishtinë, lidhur me Konkursin Publik nr. 311 të datës 16.02.2018, të publikuar në të përditëshmen Epoka e Re me datën 17.02.2018 dhe në web-faqen e KRU „Prishtina“ sh.a. në Prishtinë, bënë këtë:

N J O F T I M

Për anulimin e pozitës nr. 10 (Një) Teknik i TI-së sipas Konkursit nr. 311 të dt. 16.02.2018

Anulimi i kësaj pozite sipas Konkursit Publik bëhet nga arsyeja e mosvlerësimit bazik dhe final të kësaj pozite sepse jemi në proces të zhvillimit të programit ERP, ku paraprakisht duhet të bëhet një vlerësim i detajuar e më pastaj, pas finalizimit, fillohet me procedurën e publikimit.

KRU "PRISHTINA" sh.a.

Rruga Tahir Zajmi p.n., Prishtinë
Tel : 381 38 54 12 11, 381 38 55 10 10
Fax + 381 38 54 14 37

www.kur-prishtina.com
E-mail: mehdi.dervishi@kur-prishtina.com

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Arta Ademi, shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e klasës së 10,11,12 të Shkollës së Mjekësisë "Ramiz Sadiku", në Pejë.

► "Agallari" ShPK nga Prishtina shpall të pavlefshëm certifikatën e regjistrimit të biznesit me numër: 810075152 dhe certifikatën e TVSH-së: 330373423.

► Rama Asani shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " 25 Maji " Dinje Lubinje

► Miradin Osmani shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf " 25 Maji " Donje Lubinje

► Imet Osmani shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf " 25 Maji " Donje Lubinje

► Nenad Spasic shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Avdyl Frasheri " Prizren

► DPH "Makadam" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit 70246262 Prizren

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknikë në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë të sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira kati i parë, në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

*Gjithmon me merr malli për vonën tëm
Urimë dita e pavarësisë!*

RC
cola

*Urimë perjetori i 10 Kosovë
Shpresoj që 10 vjetoria e ardhshme
fëmijet e mi kanë me qare krenar
me kësi ba në sot.*


*Njëshita ka shumë punë që me arrit a
ka duhet por e di që këtu ka njëz që
shumë dhe kanë besim në ardhmerinë e*

*Sot 10 vjet kjo ditë ka qare anderr për n
Qe prej asaj dite une besoj që puna m
gjithmonë kthehet! Urimë Kosova jonë!
Zemra pushon, vuc këtu!*

10 mesazhe
Kosovës

**MADE IN
KOSOVA**

*Shpresoj ma t'mirën për Kosovën
e që vitet e ardhshme t'jone ma tsuksesshm
Gëzuar perjetori i pavarësisë!*



Revistën për kulturë, gjuhë, media, "Akademia", mund ta gjeni në redaksinë e gazetës "Epoka e re", në Sheshin "Edit Durham", 100 metra larg "Grand Hotel"-it. Për informata të tjera mund të thërrisni në këtë numër të telefonit: +377 44 127 434.